



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi ”**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë: Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1- Prof.As. Irena Saço Kola

2- Prof.As. Enkeleda Sinaj

Nëntor/2023

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Për Programin e studimit Bachelor në "Fizioterapi" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Aleksandër Moisiu", Durrës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Fizioterapi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr. 282, datë 04.07.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR 7239/1 prot., datë 17.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASR nr. 322, Nr.3088/124 Prot., datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli I
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3-vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	PAE 25 PAK 14
18	Numri i studentëve:	2017-2018 - 49 2018-2019 - 50 2019-2020 - 45 2020-2021 - 56 2021-2022- 50
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi" është një program studimi i ciklit të parë, i cili ofrohet pranë Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore, në Fakultetin e Studimeve Profesionale në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, që prej vitit 2013.

Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e ciklit të parë Bachelor në "Fizioterapi" dhe synon të përgatisë profesionistë të fushës së rehabilitimit me standarde të larta akademike bashkëkohore. Ky program studimi është hartuar për të siguruar formim të profilizuar, në gjendje që i diplomuari të veprojë me aftësi dhe pavarësi profesionale në fushën e rehabilitimit si dhe të siguroj profesionistë të rinj që t'i shërbejnë pjesës jugore të vendit, në mënyrë që të mbështesin zhvillimin e shoqërisë shqiptare dhe përparimin e arsimit dhe kërkimit universitar në nivel kombëtar.

Në mbështetje të programit të studimit, Universiteti ka ngritur sallat e procesit mësimor dhe laboratorët për zhvillimin e lëndëve bazë, posaçërisht Laboratori i Fizoterapisë, për vënien në praktikë të njohurive teorike. Universiteti e mbështet programin e studimit, edhe nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve me institucione.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës u përgatit nga dy profesorë me përvojë dhe eksperte të fushës: Prof.As. Irena Kola dhe Prof.As. Enkeleda Sinaj. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua edhe nga koordinatoreja teknike e ASCAL, Msc. Aleksandra Xhamo.

Ekspertët e vlerësimit bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga UAMD dhe në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, kanë kryer vlerësimin e jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi”. Grupi i vlerësimit u njoh dhe konsultoi fillimisht dokumentat e dorëzuara nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës për akreditimin dhe zhvilloi vizitën në ambientet e tij në datat 26-27 Qershor 2023. Gjatë këtyre ditëve u zhvilluan takime me përfaqësues të këtij institucioni, Dekanin e Fakultetit të Studimeve Profesionale, Departamentin e Shkencave Teknike Mjekësore, grupin e punës dhe stafin e programit për të kuptuar dhe pyetur më tej në lidhje me vlerësimin e brendshëm dhe realizimin e programit të studimit.

Takime u zhvilluan dhe me studentët e programit të studimit, si dhe zyrtar administrativ të Sekretarisë mësimore të FSP, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Aluminit dhe Komunikimit si dhe në Bibliotekën e Universitetit.

Si përfundim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është konsultuar për gjetjet dhe konkluzionet në këtë raport dhe kanë rënë dakord për vlerësimin e standardeve sipas rubrikave përkatëse. Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi”, ofruar nga Universitet “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Më datë 29.08.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.15/146 Prot., datë 29.08.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 30.09.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 1528 Prot., datë 02.10.2023, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin I.1, Kriteri 4, GVJ pasi analizoi objeksionin e paraqitur nga insitucioni, vazhdon ti qendroi të njëjtit vlerësim të dhene në draft. Referuar komenteve te insitucionit mbi këtë kriter dhe gjithë dokumentacionit shqyrtues gjykojmë se, në stafin përbërs me kohë të plotë paraqiten vetëm 7 lektorë, nga të cilët numri 5 dhe 7 në renditje nuk kanë titujt akademik të nevojshëm. I njëjti arsyetim vlen edhe për lektorët me kohë të pjesëshme, pjesa me e madhe e tyre janë pa përfituar tituj shkencor. GVJ vlerëson përpjekjen e institucionit mbi përmirësimin e CV-ve të stafit, megjithatë gjykon se ky kriter nuk mund të përmbushet plotësisht nga ai.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin I.2, Kriteri 1, GVJ pasi analizoi objeksionin e paraqitur nga insitucioni, vazhdon ti qëndroj të njëjtit vlerësim të dhene në draft. Për mbarëvajtjen e programit, institucioni nuk paraqet një analizë te detajuar mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda tij, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit. Në komentet e institucionit sqarimi mbi mbulimin e disa lëndëve nga lektorë të fakluteteve të tjera, nuk mjafton për tu përmbushur plotësisht kriteri.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin I.2, Kriteri 2, GVJ pasi analizoi objeksionin e paraqitur nga insitucioni, vazhdon t'i qëndroj të njëjtit vlerësim të dhënë në draft. Insitucioni liston disa marrëveshje bashkëpunimi dhe nga analiza e tabelës përmbledhëse në evidencën nr. 25, vihet re se shumica e marrëveshjeve janë jashtë aftatit dhe nuk janë të profilit me planin e studimit. Përmendim marrëveshjen me RaiffeisenBank Sh.a., programin e trajnimit hartuar nga FASTIP-I, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Apo marrëveshjen e parinovuar me Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë Durrës, datë 5/07/2017 me afat 5 vjeçar sipas nenit 5 të kësaj kontrate e vlefshme deri në Datë 5/07/2022, siç është cituar në komente nga vetë insitucioni.

Gjithashtu, institucioni nuk paraqet asnjë plan praktikash të shpërndarjes së studenteve sipas nje kalendari nëpër institucionet bashkëpunuese. GVJ gjykon se kjo gjë duhet të shihet si prioritare nga nënshkrimi i marrëveshjeve me institucione publike dhe private për praktikat profesionale. Ky kriter nuk mund të përmbushet plotësisht nga insitucioni.


**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

4. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.1, Kriteri 1, Arsyeq që insitucioni raporton në komentet e tij, janë marrë në konsiderate gjatë hartimit të draft raportit prandaj edhe vlerësimi për standardin në tërësi është paraqitur kryesisht i përmbushur. Programi i studimit është organizuar në lëndë e module sipas VKM nr.41, por GVJ përfshin nje sqarim të mëtejshëm të sasisë mesatare të punës së kryer gjatë një viti studimi nga një student me kohë të plotë, në orë mësimore pune, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij. GVJ vlerëson objeksionin e paraqitur nga insitucioni dhe ndryshon raportin e tij.

**Raporti në këtë pikë ndryshon.**

5. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.1, Kriteri 4, GVJ pasi analizoi objeksionin e paraqitur nga insitucioni, vazhdon ti qëndroj të njëjtit vlerësim të dhënë në draft raportin. Në kriter GVJ paraqet opinionin se në planin mësimor të programit te studimit janë të përcaktuara ngarkesat në kredite për realizimin e praktikave mësimore dhe përfshin një sqarim të mëtejshëm lidhur me vendet e zhvillimit të praktikës, dhe bashkëpunimet me institucionet ku kryhen praktikat mësimore. Për sa më sipër GVJ vazhdon t'i qëndroj të njëjtit vlerësim të dhënë në draft raport.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**



6. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.1, Kriteri 8, GVJ pasi analizoi objeksionin e paraqitur nga insitucioni, vazhdon t'i qëndroj të njëjtit vlerësim të dhënë në draft. Institucioni nuk aplikon programe studimi të përbashkëta me institucione të tjera të arsimit të lartë, vendas apo të huaj. GVJ gjykon pjesën se, mos qenia program i përbashkët nuk përmbush çfarë kriteri 8 kërkon dhe jo pjesën mbi cilësinë totale të institucionit. Për sa më sipër GVJ vazhdon t'i qëndroj të njëjtit vlerësim të dhënë në draft raport.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

7. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.2, Kriteri 1 Arsyet që institucioni raporton në komentet e tij, janë marrë në konsiderate gjatë hartimit të draft raportit prandaj edhe vlerësimi për standardin në tërësi është paraqitur kryesisht i përmbushur. Në analizën e stafit akademik vërehet përsëritje e stafit në module të ndryshme dhe mungesë e stafit akademik të specializuar. Për sa më sipër, GVJ vazhdon t'i qëndroj të njëjtit vlerësim të dhënë në draft raport.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

8. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.3, Kriteri 2, Programi i studimit është organizuar në lëndë e module sipas VKM nr.41, por GVJ në vlerësim përfshin një sqarim të mëtejshëm të sasisë mesatare të punës së kryer gjatë një viti studimi nga një student me kohë të plotë, në orë mësimore pune, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë jashtë. GVJ vlerëson objeksionin e paraqitur nga insitucioni me komentet e paraqitura dhe ndryshon vlerësim të dhënë në draft raport.

**Raporti në këtë pikë ndryshon.**

9. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.4, Kriteri 4 Elementet që institucioni raporton në komentet e tij, janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të draft raportit. GVJ ka dhënë opinionin e tij pozitivë dhe të drejtë për këtë kriter. Raporti midis formimit teorik dhe praktik është shprehur në program sipas VKM nr. 41. Peshat respektive 20% dhe 80% janë paraqitur në vlerësim referuar tabelës në evidencen Nr.40. Dosja e programit të studimit, 855 orë leksione dhe 3645 orë seminare dhe praktika profesionale. Për sa më sipër, GVJ vazhdon t'i qëndroj të njëjtit vlerësim të dhënë në draft raport.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

10. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin III.1, Kriteri 4, GVJ pasi analizoi objeksionin e paraqitur nga insitucioni, vazhdon t'i qëndroj të njëjtit vlerësim të dhënë në draft raportin. Referuar komenteve të insitucionit mbi këtë kriter dhe gjithë dokumentacionit shqyrtues gjykojmë se, personeli akademik parë në tërësinë e tij, nuk ishte me specializimet e kërkuara në fushën e programit dhe pa titujt e nevojshëm. Për sa më sipër, GVJ vazhdon t'i qëndroj të njëjtit vlerësim të dhënë në draft raport.





## **Raporti në këtë pikë ndryshon / nuk ndryshon.**

11.Lidhur me komentën e institucionit për Standardin IV.1, Kriteri 1, GVJ konstatojnë se (evidenca 147, tab 1,2, stafi akademik efektiv për lëndët profesionale është i pakët në numër janë vetëm dy ( 1 me MSC; dhe një me gradën Dr), me trajnimet profesionale dhe grada e tituj për lëndët profesionale të programit Bachelor Fizioterapi në UAMD. GVJ konstatojnë se personeli akademik dhe ndihmës akademik angazhuar në realizimin e programit të Studimit Bachelor në “Fizioterapi” kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e praktikave laboratorike të programit Bachelor në Fizioterapi.

GVJ nisur nga programi mësimor në tërësi në tre vite akademike konstatojnë se ky program Bachelor në Fizioterapi ka lëndë karakterizuese -profesionale – përgatitje për disiplinën shkencore (B) 50% - 55% të programit të tre viteve dhe e shprehur në kredite (98 kredite = 54%), lëndët e formimit bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) 15% - 20% e programit rreth 28 kredite , lëndë ndërdisiplinore/ integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) 12% - 15%,(22 kredite = 12%), lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D) 10% - 15% (27 kredite = 15%)Sa i takon personelit të jashtëm, vlen të theksojmë se jo të gjithë janë me grada e tituj shkencorë, por janë ekspert të lëndës që ata mbulojnë.

GVJ konstatojnë se raporti lektorë/ studentë; PAE/PAK për lëndët– përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) 15% - 20% e programit rreth 28 kredite , lëndë ndërdisiplinore/ integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) 12% - 15%(22 kredite = 12%), lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D) 10% - 15% (27 kredite = 15%), është sipas ligjshmërisë së arsimit të Lartë Shqipëtar, *por për lëndët profesionale në vecanti (jo për programin në tërësi) raporti PAE/PAK është i ulët, prandaj GVJ sygjeron rekrutimin e stafit akademik efektiv me trajnimet dhe gradat përkatëse për mësimdhënien në lëndët profesionale, mundësisht të dominoj numri i PAE ndaj PAK për lëndët profesionale.*

## **Raporti në këtë pikë ndryshon nga kryesisht në plotësisht**

11.Lidhur me komentën e institucionit për Standardin IV.1, Kriteri 2, GVJ sic u shprehëm dhe më lart, në standardin IV1/ kriterin 1, konstatojnë se PAE të lëndëve profesionale kanë një ngarkesë mësimore bazuar në udhëzimin 29 të MAS , (375-270 orë) , në këto kushte është e nevojshme të bëhet e mundur rekrutim të PAE me gradat dhe trajnimet që i përkasin këtij programi studimi, për të rritur raportin PAE/PAK dhe në këto kushte PAK të mbulojnë më pak orë.

*GVJ bazuar në shpërndarjen e ngarkesës në vite si dhe numrin e pedagogëve efektiv sygjeron, që UAMD, të bëjë të mundur rekrutimin e PAE me grada dhe trajnime specifike për programin e studimit Bachelor Fizioterapi.*

## **Raporti në këtë pikë ndryshon nga kryesisht në plotësisht**

12. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin IV.3, Kriteri 4,

GVJ ka theksuar se UAMD ka bibliotekën e institucionit të pajisur me cikle leksionesh, tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, për lëndët e formimit bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) 15% - 20% e programit rreth 28 kredite , lëndë ndërdisiplinore/ integrale – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) 12% - 15% (22 kredite = 12%), lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, të programi bachelor në fizioterapi, *por në bibliotekë mungojnë librat fizik në gjuhën shqipe apo të huaj për lëndët profesionale.*

*Ciklet e leksioneve dhe librat profesional ishin të depozituara në departament siç na u referua gjatë vizitës në institucion si ( rehabilitimi në neurologji, rehabilitimi në neuropsikologji, rehabilitimi në ortopedi).*

GVJ duke ditur që lëndë karakterizuese -profesionale përbëjnë rreth 50% - 55% të programit të tre viteve dhe e shprehur në kredite përbëjnë (98 kredite = 54%), mendon se janë pak dhe *sygjeron të shtohen librat profesional të programit Bachelor në Fizioterapi, në bibliotekë dhe të mos ruhen vetëm në departament, por dhe në bibliotekën e institucionit.*

**Raporti në këtë pikë ndryshon nga kryesisht në plotësisht**





# Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është në përputhje të plotë me strategjinë institucionale të UAMD, të zbatuar konkretisht për studimet në fushën e Fizioterapisë, si dhe përmbushjen e objektivave të Fakultetit të Studimeve Profesionale si dhe të Departamentit të Shkencave Mjekësore Teknike. Programi nxit formimin akademik dhe shkencor bashkëkohor të studentëve, mbështetur në prioritetet strategjike të zhvillimit të UAMD, që lidhen me përgatitjen e fizioterapistëve të ardhshëm me njohuri të përgjithshme dhe të profilit. <i>EVIDENCA Nr.09 “Plani Strategjik Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës për vitet 2020-2025, miratuar me Venedim të Senatit Akademik nr. 60, datë 26.10.2020”</i> <i>EVIDENCA Nr.11 “Statuti i UAMD”</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Duke analizuar Statutin dhe Misionin e UAMD, në vlerësimin tonë konfirmojmë se programi i studimit është në përputhje të plotë me qëllimin e tij, si dhe me fushën e veprimtarisë, të rregulluara edhe në aktet e brendshme të tij, të cilat synojnë promovimin e Arsimit të Lartë duke shkëmbyer njohuri dhe duke gjeneruar ide të reja dhe moderne. Gjithashtu, të promovojë dhe mbështesë projekte inovative kërkimore që inkurajojnë dhe forcojnë lidhjen midis tregut të punës dhe IAL-it, të garantojë mundësi të barabarta për stafin akademik në përfitimet e financimeve për kërkim shkencor. <i>EVIDENCA Nr.09 “Plani Strategjik Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës për vitet 2020-2025, miratuar me Venedim të Senatit Akademik nr. 60, datë 26.10.2020”</i> <i>EVIDENCA Nr.11 “Statuti i UAMD”</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Nga analiza e misionit të institucionit, shprehur edhe në rregulloren e përgjithëshme, marrëveshjet dhe objektiva të dokumentuara del qartë, që programi Bachelor në “Fizioterapi” është përgatitur në përputhje me Statutin dhe me Rregulloren e Përgjithshme të Fakultetit të Studimeve Profesionale. Në përputhje me misionin, UAMD ka si objektiv në programin e studimit aftësimin e studentëve për transformimin e tyre personal, suksesin profesional dhe përmirësimin e të mirave të përbashkëta, nëpërmjet një mjedisi dinamik, pro angazhimit në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe gjithëpërfshirje në kërkimin shkencor, nëpërmjet ofrimit të hapësirave për më shumë komunikim, diskutim të



	<p>lirë dhe të gjallë, në respekt të ndërsjelltë për formimin me bindje individuale, si akselerues i angazhimit socialkomunitar.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.09 "Plani Strategjik Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës për vitet 2020-2025, miratuar me Venedim të Senatit Akademik nr. 60, datë 26.10.2020"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.16 Rregullore FSP</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Duke analizuar aktivitetin akademik të deritanishëm mund të themi se, UAMD ka një përvijë rreth 10-vjeçare dhe kapacitetet e mjaftueshëm, por jo burime të plota në fushën akademike për ofrimin e programit të studimit Bachelor në "Fizioterapi". Stafit akademik nuk ka trajnimet dhe ekperiencën e duhur në fushën e fizioterapisë. Nga analiza e CV-ve të stafit akademik vihet re mungesë e theksuar e stafit profesionist me ekperiencën e nevojshme në këtë fushë dhe titujt akademik të nevojshëm. Vihet re se, shumica e stafit me kohë të plotë janë me titullin Msc.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.14. CV e programit te studimit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha të përgjithshme dhe fusha specifike janë në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Studimeve Profesionale dhe secila prej tyre është e kodifikuar konform direktivave.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi" ofron dije dhe aftësi të profilizuara, gjithashtu është i ndërthurur edhe me dije multidisiplinare.</p> <p><i>EVIDENCA Nr. 12 Rregullorja e UAMD</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.16 Rregullore FSP</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 30 Plani mësimor dhe tabela e veprimtarive formuese</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht, referuar analizës të dokumentacionit shqyrtues si dhe vizitës në institucion. Programi i Studimit është në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e IAL, nuk bie ndesh me interesat kombëtare, është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të IAL, por burimet në fushën akademike me staf të specializuar dhe tituj akademik janë të pamjaftueshme për lëndët karakterizuese në planin mësimor të këtij programi.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, konstatoi se UAMD nuk ka paraqitur asnjë analizë të detajuar ku të pasqyrohen marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit, ndarjes së detyrave mes</p>

<p>nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>njësive e personelit marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës. Në Statutin e Universitetit, në nenin 51, paraqiten të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik, ndërsa në Organigramën paraqitet struktura e Fakultetit të Studimeve Profesionale, por jo një analizë e mirëfilltë ku të gjykojmë arritjen e kriterit.</p> <p><i>EVIDENCA Nr. 12 Rregullorja e UAMD</i> <i>EVIDENZA Nr.130 Organigrama</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për arritjen e objektivave të procesit mësimor, institucioni liston planin historik të marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit, por ato nuk janë paraqitur të detajuara në dokumentacionin shqyrtues mbi kushtet dhe termat. Nga analiza e tabelës përmbledhëse në evidencën nr. 25, vihet re se shumicës së marrëveshjeve ju ka mbaruar afati dhe nuk janë të profilit sa i takon planit të studimit. Nga marrëveshjet aktive përmendim:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Marrëveshjen me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës - Drejtoria e Përgjithshme e Detarisë;</li> <li>2. Marrëveshjen me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës - Drejtoria e Përgjithshme e Detarisë;</li> <li>3. Marrëveshjen me Autoritetin Portual Durrës;</li> <li>4. Marrëveshjen me Hungarian Hospice-Palliative Association;</li> <li>5. Marrëveshjen me Shoqatën e Infermierëve të Shqipërisë.</li> </ol> <p><i>EVIDENCA Nr.25 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Studimeve Profesionale</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Në dokumentacionin shqyrtues GVJ analizoi një listë marrëveshesh të ndryshme bashkëpunimi të FSP, por nuk u vu re një plan specifik tregues për zhvillimin dhe shpërndarjen e praktikave nëpër institucionet bashkëpunuese të specializuara.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.25 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Studimeve Profesionale</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin e studimit ka hartuar një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit të zyrtarizuara me institucionin. Nga analiza e detajuar e tij nuk u evidentua asnjë informacion i dobishëm lidhur me përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Në dokumentacionin shqyrtues IAL nuk paraqet asnjë raport periodik lidhur me benefitet e marra nga bashkëpunimet në lidhje me praktikat mësimore apo për stafin akademik.</p> <p><i>EVIDENCA Nr. 28 Raportet mbi ecurinë e bashkëpunimit</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht, referuar analizës së dokumentacionit shqyrtues si dhe takimeve me stafin gjatë vizitës. UAMD liston planin historik të marrëveshjeve të bashkëpunimit me shumë institucione brenda dhe jashtë vendit, por nuk i paraqet ato të detajuara.</p>



	IAL nuk ka paraqitur asnjë evidencë të qartë ku të pasqyrohen marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit apo jashtë tij, me institucione të specializuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.																
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve															
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ vlerëson se kurrikula e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi është e organizuar me lëndë të vlerësuara në kredite përkatëse sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Referuar planit mësimor të programit të studimit disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në lëndë dhe module të specifikuara në 5 kategori nga A-E, sipas tabelës në vijim:															
	<table border="1"> <tr> <td>A</td> <td>LËNDË BAZE</td> <td>16% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>LËNDË KARAKTERIZUESE</td> <td>54% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE</td> <td>12% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>LËNDË PLOTËSUESE</td> <td>15 % (kredite)</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td>3% (kredite)</td> </tr> </table>		A	LËNDË BAZE	16% (kredite)	B	LËNDË KARAKTERIZUESE	54% (kredite)	C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE	12% (kredite)	D	LËNDË PLOTËSUESE	15 % (kredite)	E	DETYRIME PËRMBYLLËSE
A	LËNDË BAZE	16% (kredite)														
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	54% (kredite)														
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE	12% (kredite)														
D	LËNDË PLOTËSUESE	15 % (kredite)														
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3% (kredite)														
	GVJ konstatoi se në planin mësimor paraqiten lëndët dhe ndarja në secilën prej tyre në leksione, seminare, laboratore, orë praktike.															
	<i>EVIDENCA Nr. 30. Plani mësimor dhe tabela e veprimtarive formuese. EVIDENCA Nr.40. Dosja e programit te studimit (kurrikula , plani mësimor, dhe personeli akademik)</i>															
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose	Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” përmban lëndë dhe module të cilat synojnë formimin e studentit si profesionist me njohuri bazë dhe specifike bazuar në metoda e parime shkencore si dhe në metodologjinë moderne të rehabilitimit duke ndërthurur formimin teorik e praktikë. Programi synon të pajisë studentët me njohuri dhe shprehi të veçanta, që															

<p>punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>do t'u shërbejnë atyre në punësim. Veç lëndëve bazë dhe karakterizuese në program janë parashikuar module të etikës, menaxhimit shëndetësor, gjuhë të huaja, latinisht dhe psikologji.  <i>EVIDENCA Nr.17. Rregullore e programit të studimit Fizioterapi.</i>  <i>EVIDENCA Nr.40. Dosja e programit të studimit (kurrikula, plani mësimor, dhe personeli akademik)</i></p>															
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi", ka të përcaktuar veprimtaritë formuese, duke grupuar modulet sipas kategorive dhe me ngarkesën respektive në kredite. Ne planin e studimit të programit përqindja totale e lëndëve për kategoritë A dhe B është 70% dhe është në kufi me respektimin e limitin &gt;70%, e specifikuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018, i ndryshuar, në rastin Bachelor.</p> <p>Tabela më poshtë paraqet limitet e kërkuara për secilën kategori:</p> <table border="1" data-bbox="539 864 1390 1144"> <tr> <td>A</td> <td>LËNDË BAZE</td> <td>15-20 % (kredite)</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>LËNDË KARAKTERIZUESE</td> <td>50-55% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE</td> <td>12-15 % (kredite)</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>LËNDË PLOTËSUESE</td> <td>10-15 % (kredite)</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td>3-5 % (kredite)</td> </tr> </table> <p><i>EVIDENCA Nr.17. Rregullore e programi të studimit Fizioterapi.</i>  <i>EVIDENCA Nr.40. Dosja e programit të studimit (kurrikula, plani mësimor, dhe personeli akademik).</i></p>	A	LËNDË BAZE	15-20 % (kredite)	B	LËNDË KARAKTERIZUESE	50-55% (kredite)	C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE	12-15 % (kredite)	D	LËNDË PLOTËSUESE	10-15 % (kredite)	E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3-5 % (kredite)
A	LËNDË BAZE	15-20 % (kredite)														
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	50-55% (kredite)														
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE	12-15 % (kredite)														
D	LËNDË PLOTËSUESE	10-15 % (kredite)														
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3-5 % (kredite)														
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në planin mësimor të këtij programi studimi janë të përcaktuara ngarkesat në kredite për realizimin e praktikave mësimore, gjithsej 180 kredite, ndarë në 6 semestra në 3 vite akademike.</p> <p>IAL në dokumentacionin shqyrtues nuk listohen vendet e zhvillimit të praktikës, dhe bashkëpunimet me institucionet ku kryhen praktikat mësimore, nuk tregohen të detajuara me kontrata apo marrëveshje të nënshkruara. Institucioni nuk ka paraqitur një plan specifik tregues për zhvillimin dhe shpërndarjen e praktikave nëpër institucione të specializuara.</p> <p>Gjithashtu, në këtë program studimi është përcaktuar forma e detyrimeve përmbyllëse, e cila është me provim mbrojtje temë diplome dhe ka 5 kredite ose 3.33% të peshës së programit. Ky kriter është paraqitur i pasaktë në RVB- në e pëgatitur nga UAMD.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.17. Rregullore e programi të studimit Fizioterapi.</i>  <i>EVIDENCA Nr.25 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Studimeve Profesionale</i>  <i>EVIDENCA Nr. 27 "Rregullore e laboratorëve për zhvillimin e Praktikës Profesionale"</i></p>															

	<i>EVIDENCA Nr.40. Dosja e programit të studimit (kurrikula, plani mësimor, dhe personeli akademik)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimet me stafin akademik konstatoi se syllabuset, përgatiten nga titullarët e lëndëve dhe përmbajnë të gjithë elementët sipas legjislacionit në fuqi. Neni 44 i Rregullores së programit paraqet kriteret dhe procedurën e pranimi të studentëve duke respektuar kuadrin ligjor. <i>EVIDENCA Nr.42. Kriteret e Pranimi të Studentëve, të Transferimit e Njohjes së Studimeve të mëparshme</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit ka një ngjashmëri në përmbajtje deri në 70 % me programet e studimit të ngjashme “Bachelor në Fizioterapi” të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tiranës. Lëndet, emërtimi i tyre është konform degëve të mjekësisë. Shpërndarja e tyre shpreh një synim të programit që në fillim të vitit të parë ku lëndët japin njohuritë e përgjithshme bazë për të vazhduar më tej në specialitet, çka në vitin e dytë e të tretë shton peshën e lëndëve profesionale, orët në laborator, e orët e praktikës. <i>EVIDENCA Nr.40. Dosja e programit te studimit (kurrikula, plani mësimor, dhe personeli akademik)</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit ky program studimi është i nivelit të 6 dhe siguron kualifikime e specializime për studentët e Fizioterapisë. Kodifikimi i fushave të arsimit dhe trajnimit është dhe në nivel Institucioni UAMD, me kodifikimin 09 Shëndet e Mirëqenie, 091 Shëndet, 0915 Terapi dhe Rehabilitim. <i>EVIDENCA Nr.33. Kodifikimi i Programeve ne UAMD.</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Referuar dokumentacioni shqyrtues si dhe vizitës në aktivitet u konstatua se, UAMD nuk aplikohen programe studimi të përbashkëta me institucione të arsimit të lartë, vendas apo të huaj. <i>EVIDENCA Nr.17. Rregullore e programi te studimit Fizioterapi.</i>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht, referuar analizës të dokumentacionit shqyrtues si dhe takimeve me stafin gjatë vizitës në ambientet e UAMD. Programi është i organizuar me lëndë të vlerësuara në kredite përkatëse sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Çdo modul që zhvillohet në programin e studimit është i pajisur me një kod unik, i cili korrespondon midis planit mësimor dhe syllabuseve. Në planin mësimor të programit të studimit nuk repsektohet ndarja e krediteve të lëndës për secilin komponent mësimor të saj dhe orëve që i alokohen çdo krediti.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



<b>Standardi II.2</b> <b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore dhe ato bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Fizioterapi" përmbushin pjesërisht detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin, por si strukturë, si organizim dhe si përbërje të stafit. Në analizën e stafit akademik në njësitë bazë vërehet përsëritje e stafit në module të ndryshme dhe mungesë e theksuar e stafit akademik të specializuar. Lëndët karakterizuese të programit mbulohen kryesisht nga personel i pa kualifikuar me gradat e nevojshme, mbizotëron grada Msc. Ndarja e stafit në PAE dhe PAK është parqitur në dokumentacione të ndryshme, dhe numri i tyre nuk paraqitet gjithmonë i njëjti në to. Personeli akademik i programit Bachelor në Fizioterapi në vitin akademik 2021 – 2022 përbëhet nga 10 docentë me gradën shkencore Msc, dhe 11 me gradën shkencore Dr. Asnjë lektor i brendshëm nuk ka tituj akademikë "Profesor" apo "Profesor i Asociuar" <i>EVIDENCA Nr. 35 "Të dhëna Tabelore me Ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik, në të gjitha Programet e Studimit"</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti i Shkencave Teknike Mësimore ka në përbërje të tij anëtarë staf akademik efektiv dhe staf akademik me kontratë i cili është me kohë të pjesshme ose të ftuar. Planifikimi për staf akademik me kohë të pjesshme ose të ftuar bëhet në fillim të çdo viti akademik dhe miratohet nga Dekanati dhe nga Rektorati. <i>EVIDENCA Nr.28 "Relacion Praktika Profesionale për studentët e programit të studimit"</i>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia kryesore Fakulteti i Studimeve Profesionale dhe njësia bazë Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore përgjegjëse për programin e studimit bachelor në "Fizioterapi" ka caktuar një pedagoge në rolin e koordinatores së këtij programi studimi, e cila është përgjegjëse për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Gjithashtu ndjek ecurinë e regjistrimeve, transferimeve të studentëve dhe monitoron realizimin e projekteve. <i>EVIDENCA Nr. 21 "Rregullore e Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore"</i>
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht, referuar analizës së dokumentacionit shqyrtues si dhe takimeve me stafin gjatë vizitës në ambientet e UAMD. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore për programin e studimit Bachelor në Fizioterapi, plotëson kriteret e nevojshme për sa i përket organizimit dhe strukturën akademike, por jo për titujt akademik. Përgjegjësit e programit të studimit në Departamentin e Shkencave Teknike Mjekësore nuk kanë titujt akademikë të nevojshëm.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Fakulteti i Studimeve Profesionale, është përgjegjës në kryerjen e funksionit si njësi kryesore, duke patur informacionin dhe dokumentat e nevojshme për të gjithë elementet e programit të studimit: rregullore, planet mësimore, numrin dhe ngarkesën mesimore të çdo pedagogu, organizimin e praktikave profesionale, strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, kalendarin e provimeve, etj. <i>EVIDENCA Nr.16. Rregullore FSP + Vendim SA + V Dekanati</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ gjykon se programi i studimit është i ndarë në lëndë, module, praktikë dhe aktivitete formuese të cilat zhvillohen në 3 vite akademike, në 6 semestra në total dhe 2 semestra në secilin vit akademik. Plani mësimor përfshin informacionin e nevojshëm në lidhje me ngarkesën mësimore, e cila përfshin ngarkesën në orë në auditor dhe jashtë auditorit, që zënë komponentët mësimorë, leksionet, seminarët, laboratorët, praktikat, forma e kontrollit të vazhduar, etj. Orët në auditor dhe orët jashtë auditorit së bashku përbëjnë sasinë mesatare të punës së kryer nga një student gjatë një viti studimi, që është 60 kredite x 25 orë mësimore për kredit 1500 orë mësimore punë të studentit. Programi në total ka 4500 orë në 3-vite akademike. <i>EVIDENCA Nr. 35 "Të dhëna Tabelore me Ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik, në të gjitha Programet e Studimit"</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	I gjithë informacioni i nevojshëm që lidhet me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve është pasqyruar në Rregulloren e Fakultetit. Bazuar në rregulloren e njësisë kryesore, pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet në fakultet bëhet në bazë të kriterëve që vijojnë : -Studentë të cilët zotërojnë një diplomë që vërteton përfundimin e shkollës së mesme; -Mesatarja e notave sipas VKM duke i rankuar në rend zbritës; -Studentë që zotërojnë një diplomë të lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë kanë mundësi të aplikojnë për t'u pranuar në IAL <i>EVIDENCA Nr.16. Rregullore FSP + Vendim SA + V Dekanati</i> <i>EVIDENCA Nr. 42. Kriteret e Pranimit të Studentëve, të Transferimit e Njohjes së Studimeve të mëparshme</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë	Përmbajtja e syllabuseve të lëndëve në program kanë elementët e përcaktuar nga VKM Nr.41 24.01.2018, shtojca nr.2 si: titullari, ngarkesa dhe tipologjia. Metodatat e mësimdhënies dhe format e vlerësimit të studentit janë të përshtatshme për çdo lëndë dhe në raporte të duhura sipas lëndës, përmbajnë informacionet e nevojshme të detajuara në lidhje me objektivat e lëndës, tematikat e leksioneve dhe

komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	seminareve, orët brenda dhe jashtë auditorit. Literatura e pasqyruar në syllabuse nuk është e azhornuar me botime bashkëkohore. Programet si në strukturë dhe përmbajtje, janë të kuptueshme, mund të përballohen nga studentët dhe u japin atyre një formim bashkëkohor të fizioterapeutit. <i>EVIDENCA Nr.39 "Syllabus për programin e Studimit Bachelor në Fizioterapi"</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesit e Departamentit GVJ gjykon se, UAMD synon të mundësojë përmirësimin e programeve të studimeve nëpërmjet personelit akademik në përputhje me aktualitetet shkencore si dhe të modifikojë kur e sheh të arsyeshme metodologjinë e mësimdhënies për të përmirësuar nivelin e përfitimit nga studentët. Programi i studimit ka filluar në vitin akademik 2013-2014. Nga ai vit programi ka pësuar ndryshime në përmbajtje me riorganizimin në vitin akademik 2017-2018. <i>EVIDENCA Nr.01 "Urdhër i hapjes së programit të studimit bachelor në "Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA Nr. 35 "Të dhëna Tabelore me Ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik, në të gjitha Programet e Studimit"</i>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht, referuar analizës të dokumentacionit shqyrtues dhe nga biseda me stafin akademik. Programi i studimit është i ndarë në lëndë, module, praktikë dhe aktivitete formuese të cilat zhvillohen në 3 vite akademike, në 6 semestra në total dhe 2 semestra në secilin vit akademik. Literatura e pasqyruar në syllabuse nuk është e azhornuar me botime bashkëkohore.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht <b>X</b>	Përmbushet plotësisht

<b>Standardi II.4</b> <b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Bazuar në planin mësimor GVJ gjykon se përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive profesionale. Praktikant mësimore zënë mbi 10% të ngarkesës totale të programit. <i>EVIDENCA Nr. 35 "Të dhëna Tabelore me Ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik, në të gjitha Programet e Studimit"</i>
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave	Plani mësimor përfshin informacionin e nevojshëm në lidhje me ngarkesën mësimore, e cila përfshin ngarkesën në orë në auditor dhe





formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	jashte auditorit, që zënë komponentët mësimorë, leksionet, seminarët, laboratorët, praktikat, forma e kontrollit të vazhduar, etj <i>EVIDENCA Nr.40. Dosja e programit të studimit (kurrikula , plani mësimor, dhe personeli akademik)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Organizimi i programit Bachelor në “Fizioterapi “në UAMD, mundëson kryesisht arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënit që synon ky institucion. Programi është i shpërndarë në 3- vite studimi me 2-semester secili dhe në total ka 180 kredite. Programi mësimor është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që ju shërben studentëve për të marrë dije profesionale teorike dhe praktike në fushën e fizioterapisë. <i>EVIDENCA Nr.40. Dosja e programit të studimit (kurrikula , plani mësimor, dhe personeli akademik)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Raporti midis formimit teorik dhe praktik është shprehur në program sipas VKM nr 41 datë 24.01.2018, i ndryshuar. Në vitin e parë në planin mësimor nuk janë vendosur praktikat mësimore. Në vitin e dytë praktika zë rreth 300 orë gjithsej. Në program leksionet zënë rreth 20% të orëve gjithsej dhe pjesa tjetër (seminare e praktikë profesionale) 80% të orëve. <i>EVIDENCA Nr.40. Dosja e programit te studimit (kurrikula , plani mësimor, dhe personeli akademik)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Përmbajtja e syllabuseve të lëndëve në program kanë elementët e duhur të përcaktuar sipas VKM Nr.41 24.01.2018, shtojca nr.2. Nga analiza e syllabuseve të vëna në dispozicion u vune re se, literatura e pasqyruar në to paraqitet e vjetëruar (jo bashkëkohore). Ajo nuk është azhurnuar dhe vërehet mungesa e literaturës së huaj bashkëkohore. <i>EVIDENCA Nr.39 “Syllabus për programin e Studimit bachelor në Fizioterapi”</i>
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Program i studimit Bachelor në “Fizioterapi“ garanton përfitimin e dijeve në fushën e rehabilitimit. Ai synon të pajisë studentët me njohuri dhe shprehje komplementare, që do tu shërbejnë atyre në punësim. Lëndët e programit mundësojnë formimin bazë rehabilitues, klinik, specific dhe praktik sipas synimeve të përcaktuara. <i>EVIDENCA Nr.40. Dosja e programit te studimit (kurrikula, plani mesimor, dhe personeli akademik)</i>
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programeve të studimit mundëson punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës në vendin tonë si dhe i ndihmon ata për studime të mëtejshme të avancuara. <i>EVIDENCA Nr.40. Dosja e programit te studimit (kurrikula , plani mësimor, dhe personeli akademik)</i>
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht pas shqyrtimit të dokumentacionit si dhe vizitës në institucion. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, është në përputhje me profilin e programit bachelor në vendin tonë. Ndërsa ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, e laboratorë për çdo disiplinë, nuk respektohen në planin mësimor. Programi i studimit garanton kryesisht marrjen e njohurive, aftësive dhe kompetencave të

	synuara në nivelin Bachelor dhe i ndihmon studentët për studime të mëtejshme të avancuara.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Nuk u evidentua asnjë dokument justifikues ku të tregohej përpjekja e IAL-së në konsultimet dhe propozimet e institucioneve partnere, të të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. GVJ gjykon se përmirësimi i vetëm i dokumentuar vjen nga sugjerimet e lektorëve të departamentit dhe sugjerimet e studentëve nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të lektorit.  <i>EVIDENCA Nr. 56 "Formular i vlerësimit të pedagogëve nga studentët"</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Në nenin 80 të Rregullores së Fakultetit të Studimeve paraqitet përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to. Çdo personel akademik në fund të lëndës semestrale mbledh mendime dhe sugjerime nga studentët dhe i percjell në mbledhjen e posaçme të departamentit. <i>EVIDENCA Nr. 16 "Rregullorja e FSP"</i>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Nuk u evidentua asnjë dokument justifikues ku të tregohej se si pasojë e bashkëpunimeve me institucione publike e private, UAMD përditëson dhe riorganizon programe specifike për nevojat lokale.  <i>Vizita në Institucion</i>
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht pas shqyrtimit të dokumentacionit si dhe vizitës në institucion. IAL ofron programin Bachelor në "Fizioterapi" në përshtatje ndaj kërkesave të tregut, por ai nuk paraqet një analizë të mirëfilltë të studimit të tregut të punës dhe të të punësuarve nga studentët e diplomuar. GVJ-së nuk i'u paraqit ndonjë evidencë mbi kontaktet dhe konsultimet me institucionet partnere, me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në programin mësimor, GVJ gjykon se UAMD garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat e nevojshme. Format e Mësimdhënies janë: leksion, seminar, ushtrimet, laboratorët, praktika mësimore, detyrat e kursit etj. Në mbështetje të procesit të mësimdhënies departamenti organizon dhe ndarjen e praktikës mësimore në institucione të ndryshme, si pjesë lëndore e planit mësimor për këtë program studimi.  <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr. 16 "Rregullorja e FSP"</i>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Stafi akademik në UAMD angazhohet për të ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit Bachelor në "Fizioterapi" në përgjithësi dhe specifikisht për module të veçanta dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i> <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i> <i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP".</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Fakulteti i Studimeve Profesionale nxit përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimin të kompetencave didaktike dhe për këtë arsye herë pas here organizohen aktivitete të ndryshme. Aktivitete të shumta në formën e leksioneve të hapura, ku ftohen ekspertë fizioterapistë, të cilët janë pjesë e aktiviteteve që organizohen në ndihmë të studentëve. Gjithashtu, personeli akademik gjatë mësimdhënies përdor metoda të ndryshme dhe fleksible për studentët. Mësimdhënia në distancë ishte një metodë fleksibël që u përdor gjerësisht gjatë pandemisë.



	<p><i>EVIDENCA Nr.54.1 Trajnime online nga CEPUS për stafin akademik.</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.24 Leksionet e hapura.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studenti mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga informacioni i vënë në dispozicion nga IAL dhe vizita në ambientet e tij u vu re se, personeli akademik nuk ishte me specializimet e kërkuara në fushën e programit dhe pa titujt e nevojshëm, për të gëzuar njohuritë dhe konceptet e duhura në mësimdhënien e programit.</p> <p><i>EVIDENCA Nr. 14.CV -të e programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>DSHTM përmes vlerësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies, me qëllim përmirësimin e tyre të vazhdueshëm, në funksion të rritjes së efikasitetit të mësimdhënies mbështet studentët si pjesë integrale e përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies. Përmes anketimeve të zhvilluara merren mendimet e tyre për këtë proces, mendime dhe ide të cilat reflektohen në format e mësimdhënies. Rezultatet e pyetësorit përdoren nga njësia kryesore për hartimin e politikave të përmirësimit në mësimdhënie. Sipas kërkesave të studentëve për të ulur kufirin e kalueshmërisë, UAMD ka miratuar skemën e re të vlerësimit me pikë të provimit e cila paraqitet në syllabusin e çdo lënde, ndërkohë që skema e vlerësimit që është aplikuar më parë e ka kufirin e kalueshmërisë prej 595 pikësh për të marrë notën kaluese pesë, ndërsa tani për të kaluar lëndën studentit i nevojiten 505 pikë</p> <p><i>EVIDENCA Nr.36 Rregullorja e NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë zhvillojnë mekanizma të monitorimit, vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Kjo Drejtori është përgjegjëse kundrejt hartimit të kalendarit të procesit të vetëvlerësimit në nivel institucional, ndjek realizimin e tij, si dhe bashkëpunon me drejtuesit e Fakultetit të Studimeve Profesionale e të Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore për realizimin e procesit të vetëvlerësimit dhe ecurinë e veprimtarisë mësimore.</p> <p>Gjithashtu, IAL ka krijuar figurën e koordinatorit duke synuar që nëpërmjet tij të promovohet përmirësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies, koordinimi dhe bashkërendimi me njësitë kryesore, aktivitetet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>EVIDENCA Nr. 36 "Rregullore e NJSBC".</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion si dhe vizitës në aktivitet. UAMD</p>

	paraqet zhvillimin e mësimit, mësimit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën e nevojshme. Stafit akademik në UAMD nuk ishte me specializimet e kërkuara në fushën e programit dhe pa titujt e nevojshëm, për të gëzuar njohuritë dhe konceptet e plota në mësimitin e programit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mënyrat e mësimit në programin e studimit Bachelor në "Fizioterapi" janë leksionet, seminarët, laboratorët, praktika, detyrat e kursit etj. Rregullorja e Departamentit, Neni 68 përcakton qartësisht sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve. Praktika e punës në institucion është konform detyrimeve ligjore përsa i përket informimit të studentëve mbi metodologjinë e vlerësimit. Të gjithë studentët informohen në mënyrë të detajuar në orët orientuese, në stendën e fakultetit dhe në faqen zyrtare të UAMD. <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Strukturat e syllabuseve sipas VKM nr.41 datë 24.01.2018, e ndryshuar, përcaktojnë mënyrat dhe metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore për studentët. Syllabuset respektojnë të njëjtin format dhe sikurse rezultoi nga biseda me stafin akademik ato prezantohen në fillim të çdo lënde nga titullari i saj tek studentët. <i>EVIDENCA Nr.25 "Syllabuset e programit të studimit Bachelor në "Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i njohurive të studentëve për secilën lëndë bëhet duke mbledhur maksimumin e pikëve që mund të merret për një lëndë (1000 pikë). Kjo mënyrë vlerësimi i jep mundësi studentëve që pas njohjes me rezultatet e provimit të parë të rikuperojnë dhe të kenë mundësi të dalin me rezultate më të mira në çdo lëndë. Format e provimit janë në përputhje me specifikat e lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit të parashikuar në nenin 69 të Rregullores së DSHTM. <i>EVIDENCA Nr.57 "Model Syllabusi, ku tregohet Mënyra e Vlerësimit të Studentëve"</i> <i>EVIDENCA Nr.21 "Rregullorja e DSHTM"</i>
<b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimit në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke	DSHTM zhvillon një proces vlerësimi për metodologjitë e mësimit, që përfshin në të edhe studentët, duke marrë mendimet dhe sugjerimet e tyre. Këto metodologji miratohen nga pedagogët që përfshijnë edhe studentët me ballafaqime të ndryshme për përmirësimin e kurrikulave.

reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	<i>EVIDENCA Nr.21 "Rregullorja e DSHTM"</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Detyrat/projekt kurset janë një mënyrë e vlerësimit të punës personale apo në grup të studentëve. Aktivizimi gjatë gjithë semestrit dhe veprimtaria e studentit gjatë seancave të praktikës lëndore apo orëve laboratorike është një mënyrë tjetër e vlerësimit. Metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.  <i>EVIDENCA Nr.16 Rregullorja e FSP</i>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion si dhe vizitës në institucion. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen qartë në Rregulloren e programit të studimit. Njohuritë e studentëve sipas lëndëve dhe specifikave të tyre, vlerësohen duke u bazuar në vlerësimin për detyra, kontrollit të vazhdueshëm, prezantime, projekte e provim përfundimtar dhe pjesëmarrje aktive në mësim.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Gjatë takimeve u konstatua se njohuritë e studentëve sipas lëndëve vlerësohen duke u bazuar në vlerësimin për detyra, kontrollit të vazhdueshëm, prezantime, projekte e provim përfundimtar dhe pjesëmarrje aktive në mësim. Kjo mënyrë e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës. Çdo provim i një lënde është i ndarë në dy pjesë (dy provime për secilën lëndë). Kjo metodë i jep mundësi studentëve të dalin me rezultate të kënaqshme. <i>EVIDENCA Nr.16 Rregullorja e FSP</i> <i>EVIDENCA Nr.25 "Syllabuset e programit të studimit Bachelor në "Fizioterapi"</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe mrisin transparencën.	IAL për zhvillimin e provimeve ka aplikuar platformën Clean Score, kryesisht në kohën e pandemisë. Ky lloj sistemi do të vazhdoj të aplikohet gjërësisht në zhvillimin e provimeve. <i>EVIDENCA Nr.85 Sistemi Pitagora</i>



<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ konstatoi se vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi duke garantuar vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti. <i>EVIDENCA Nr.16 Rregullorja e FSP</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Përgjatë vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, në varësi nga natyra e lëndës, pas çdo provimi komisionit të provimit i kërkohet t'i shpjegojë studentit vlerësimin e bërë dhe nëse provimi është edhe në formë të shkruar, të ballafaqojë përgjigjet e studentit me tezën e zgjidhur, duke e ndihmuar të përmirësohet në të ardhmen. <i>EVIDENCA Nr.16 Rregullorja e FSP</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Këto detyrime parashtrihen në rregulloret e IAL dhe Kodin e Etikës, të cilat pasqyrojnë penalitetet për raste të tilla. <i>EVIDENCA Nr.16 Rregullorja e FSP</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritokracinë dhe jepen në orën pasardhëse pas kryerjes së provimeve të ndërmjetme dhe jo me vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët kanë të drejtat për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të pedagogut të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim Dekanit të Fakultetit. <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në rast ankimi, njësi bazë ngre komisionin e shqyrtimit të ankimit, i cili shqyrton dhe jep vlerësimin përfundimtar për studentin. Komisioni raporton në përfundim të drejtuesit të departamentit. <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht pas takimeve të studentëve. Çdo kërkesë apo ankimim i tyre përpara i takon vlerësimit të njohurive, shqyrtohet nga komisioni vlerësimit me procedurë transparente dhe të dokumentuar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktika, përmbajtja e tyre dhe metodat e mësimdhënies krijojnë mundësinë dhe garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p>Alternimi i lëndëve të formimit të përgjithshëm, me ato të formimit karakterizues apo plotësues, i ndihmon studentët të fitojnë dhe zhvillojnë aftësi profesionale në fushat e studimit që ofron ky program studimi, të cilat përforcohen edhe nëpërmjet laboratorëve dhe zhvillimit të praktikës profesionale.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.40 "Dosja e plotë e programit Bachelor në Fizioterapi"</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit. Në kurrikulat e programit të studimit Bachelor në "Fizioterapi", studentët zhvillojnë disa lëndë me zgjedhje jo teknike, si: Gjuhë Latinisht, Geriatri, Ekonomi, Sociologji, që kontribuojnë në formimin e përgjithshëm të tyre.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.40 "Dosja e plotë e programit Bachelor në Fizioterapi"</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në përfundim të ciklit të lëndës pedagogu analizon dhe bën vlerësimin e aftësive dhe kompetencave të fituara prej studentëve, nëpërmjet disa kritereve si: testimi përfundimtar, prezantimi i detyrave të kursit apo pjesëmarrja aktive gjatë gjithë procesit mësimor.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.16 Rregullorja e FSP</i> <i>EVIDENCA Nr.25 "Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi"</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni shqyrtues vihet re se personeli akademik shpreh disponibilitet për mbështetjen e studentëve për problemet e mbarëvajtjes së studimeve. Këto janë detyrim e përgjegjësi që u ngarkon rregullorja e Institucionit.</p> <p>Në planifikimin e aktiviteteve të departamentit, në fillim të çdo viti akademik, planifikohen orët e hapura që do të organizojnë lektorët në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Këto leksione të hapura kryhen duke ftuar personalitete të specializuara të fushës të cilët ndajnë përvojat e tyre profesionale me studentët dhe lektorët, mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë dhe si këto zhvillime do t'i shërbejnë studentëve.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.16 Rregullorja e FSP</i> <i>EVIDENCA Nr.24 "Leksionet e hapura për programin e studimit"</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, që zhvillon mësim në programin e studimit Bachelor në "Fizioterapi" realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.24 "Leksionet e hapura për programin e studimit"</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion si dhe vizitës në aktivitet. Personeli</p>

	akademik, efektiv dhe me kontratë, që zhvillon mësim në programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi” realizon orë të hapura mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	IAL paraqet një procedurë të qartë të miratuar për provimin final gjithëpërfshirës dhe diplomimit të studentëve. Ajo është pasqyruar edhe në rregulloret përkatëse të Universitetit. <i>EVIDENCA Nr.16 Rregullore e FSP</i> <i>EVIDENCA Nr.66 “Udhëzim koordinatori për provimin final”</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmblylëse.	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore përcakton udhëheqësit shkencor për diplomantët, sipas fushë-temave të ekspertizës dhe miraton tezën e diplomës. Udhëheqësi shkencor siguron që studenti të marrë mbështetjen dhe udhëzimet e nevojshme për të kryer punë kërkimore të suksesshme individuale. <i>EVIDENCA Nr.16 Rregullore e FSP</i>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Gjatë takimit me stafin akademik rezultuan se komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë 3-viteve akademike, duke patur informacion dhe përfshirë të gjitha lëndët në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. <i>EVIDENCA Nr.16 Rregullore e FSP</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Pas takimeve me stafin akademik GVJ konstatoi se, studentët janë në orientim të vazhduar nga stafi akademik për provimin e diplomës. Stafi akademik i ndihmon studentët për çdo problematikë që ata hasin gjatë përgatitjes për provimin final. <i>EVIDENCA Nr.16 Rregullore e FSP</i>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Njësia bazë, Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, në varësi të kërkesave dhe nevojave të temës së kërkimit shkencor, në bashkëpunim me institucione shëndetësore partnere, u siguron



	<p>diplomantëve mjediset e nevojshme e të përshtatshme për kryerjen e matjeve, vlerësimeve dhe testeve.  <i>EVIDENCA Nr.66 "Udhëzim koordinatori për provimin final"</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësim i Provimit Final dhe ai i Mikrotezës dhe Tezës së Diplomës bëhet me notë, nga një Komisioni i përbërë nga lektorë të Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore.  <i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Rezultatet e provimit final u jepen studentëve në fund të ditës së provimit. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me listën e notave sipas planit të studimit të zhvilluar, suplementin e diplomës dhe diplomën, formati i së cilës është miratuar nga MAS.   <i>EVIDENCA Nr.16 Rregullore e FSP</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Gjatë takimit me sekretarinë mësimore GVJ konstatoi se të gjitha dokumentat e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas kërkesave të vitit përkatës dhe një kopje e tyre arkivohet gjithashtu pas diplomimit të studentëve dhe mbeten në dosjen e tyre studentore sipas periudhës së studimit. Në çdo kohë studentët kanë në dispozicion dokumente specifike që provojnë statusin e tyre studentor për arsye të ndryshme.  <i>EVIDENCA Nr.16 Rregullore e FSP</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion si dhe vizitës në institucion. Programi i provimit përfundimtar të formimit është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Detyrimi përmbyllës bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë 3-viteve akademike, duke patur informacion dhe përfshirë të gjitha lëndët në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p><b>Standardi IV.1</b>  <b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Email: info@ascal.al

**Kriteri 1.**  
Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

GVJ bazuar në RVB, refrencat e vëna në dispozicion si dhe takimin me drejtues të institucionit konstaton se personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohen në realizimin e programit e studimit bachelor në “ Fizioterapi” përbushin kërkesat ligjore në fuqi. GVJ bazuar në evidencën 147, tab 1,2 konstaton se Departamenti i Shkencave Teknike Mjeksore (DSHTM) ka staf akademik sipas viteve si më poshtë:

Viti akademik	PA E	Tituj/ grada	P A K	Tituj/ grada	PNA
2020-2021	15	9 Dr; 6 Msc	52	1Prof.Dr;1Prof.A soc; 10 Dr; 2 proces Dr; 38 Msc	2(Msc)
2021-2022	15	9 Dr;1proc .Dr; 5 Msc	53	2Prof.Dr;1Prof.A soc; 11 Dr; 2 proces Dr; 37 Msc	2(Msc)
2022-2023	16	10 Dr; 1proc.Dr; 5 Msc	49	1Prof.Dr; 11Dr; 1 proces Dr; 36 Msc	2(Msc)

Siç vërehet evidencën 147, tab 1,2 , stafi akademik efektiv për lëndët profesionale është i pakët në numër janë vetëm dy ( 1 me MSC; dhe një me gradën Dr), me trajnimet profesionale dhe grada e tituj për lëndët profesionale të programit Bachelor Fizioterapi në UAMD .

GVJ konstaton se personeli akademik dhe ndihmës akademik angazhuar në realizimin e programit bachelor në “Fizioterapi” kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e praktikave laboratorike të programit Bachelor në Fizioterapi .

Përgjegjësi i programit të studimit është me gradën Dr. me përvojë akademike. Lektorët e angazhuar në zhvillimin e programit të studimit janë lektorë me grada dhe tituj (1 me titull Profesor Doktor, dhe të tjerët me gradë shkencore Doktor), por siç u shprehëm dhe më lart për lëndët profesionale janë vetëm 2 PAE ( 1 me gradën Dr; 1 me MSC) dhe programi mësimor ka lëndë karakterizuese -profesionale – përgatitje për disiplinën shkencore (B) 50% - 55% të programit të tre viteve dhe e shprehur në kredite (98 kredite = 54%), kjo sipas GVJ, krijon mbingarkesë për stafin PAE, prandaj GVJ shprehet se është e nevojshme rekrutimi i stafit PAE për lëndët profesionale, sipas ligjshmërisë së Arsimit të Lartë Shqipëtar si dhe me trajnime profesionale për programin bachelor në “Fizioterapi”.

GVJ gjithashtu konstaton se , 70% e ngarkesës së programit është realizuar me lektorë të brendshëm me grada e tituj shkencorë, duke patur parasysh lëndët e formimit bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) 15% - 20% e programit rreth 28 kredite , lëndë ndërdisiplinore/ integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) 12% - 15%

(22 kredite = 12%), lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D) 10% - 15% (27 kredite = 15%)  
 Sa i takon personelit të jashtëm, vlen të theksojmë se jo të gjithë janë me grada e tituj shkencorë, por janë ekspert të lëndës që ata mbulojnë.

GVJ konstaton se raporti lektorë/ studentë; PAE/PAK për lëndët–përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) 15% - 20% e programit rreth 28 kredite, lëndë ndërdisiplinore/ integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) 12% - 15%(22 kredite = 12%), lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D) 10% - 15% (27 kredite = 15%), është sipas ligjshmërisë së arsimit të Lartë Shqipëtar, por për lëndët profesionale në veçanti (jo për programin në tërësi) raporti PAE/PAK është i ulët, prandaj **GVJ sygjeron rekrutimin e stafit akademik efektiv me trajnimet dhe gradat përkatëse për mësimdhënien në lëndët profesionale, mundësisht të dominoj numri i PAE ndaj PAK për lëndët profesionale.**

*EVIDENCA Nr.04 “Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59 Kategoritë e personelit akademik”*

*Evidenca Nr.13. Cv e DSHTM.pdf*

*EVIDENCA Nr.14 “ Cv e personelit akademik për programin e studimit bachelor në Fizioterapi”*

*EVIDENCA Nr.147, 148: Tabela1,2 Tabela 1 - Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë.pdf*

*Tabela 2 \_Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit -stafi ndihmes.pdf*  
*“ Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Programin e Studimit bachelor në “Fizioterapi ”*

*EVIDENCA Nr. 46 “Udhëzim i MASR nr. 29, datë 10.09.2018 Për veprimtarinë dhe ngarkesës mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë; i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 36, datë 23.11.2018 dhe Udhëzimin nr. 37, datë 04.12.2018”*

*Vizita në institucion*

**Kriteri 2.**  
 Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

GVJ siç u shprehëm dhe më lart, konstaton se PAE të lëndëve profesionale kanë një ngarkesë mësimore bazuar në udhëzimin 29 të MAS , (375-270 orë) , në këto kushte është e nevojshme të bëhet e mundur rekrutim të PAE me gradat dhe trajnimet që i përkasin këtij programi studimi.

Ngarkesa	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK	Totali
2019-2020	1347 orë	615 orë	2/1	1962 orë
2020-2021	1520 orë	615 orë	2/1	2135 orë
2021-2022	1390 orë	615 orë	2/1	2005 orë

	<p><b>GVJ bazuar në shpërndarjen e ngarkesës në vite si dhe numrin e pedagogëve efektiv sygjeron, që UAMD, të bëjë të mundur rekrutimin e PAE me grada dhe trajnime specifike për programin e studimit Bachelor Fizioterapi.</b></p> <p><i>Evidencë nr.150 Tabela 4_Ngarkesa totale e personelit akademik të programit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në mësimdhënien në programin e studimit bachelor në “Fizioterapi” për të gjithë periudhën e akreditimit duke i pajisur me kontratën e punës duke u mbuluar me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion, takimit me zyrën e burimeve njerëzore dhe financës konstatoi se PAE të angazhuar në programin e studimit, në dosjet e tyre kanë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me drejtuesit e institucionit dhe refencave të vëna në dispozicion vuri re se ky institucion në mënyrë të vazhdueshme ka hapur konkurse për rekrutim PAE dhe PAK.</p> <p>Pavarësisht thirrjeve për rekrutim PAE në vazhdimësi, nuk ka patur rekrutime të reja.</p> <p>Procedura për rekrutimin ka një rregullore që zbatohet nga institucioni dhe vlerësimin e personelit akademik mbështetur në kritere të përcaktuara të rekrutimit referuar dhe Statutit të UAMD. Kriteret bëhen publike në sitin e UAMD (<a href="http://www.uamd.edu.al">www.uamd.edu.al</a>).</p> <p>UAMD ka faqen e tij zyrtare, në të cilën jepet informacion për fakultetet, ciklet dhe programet e studimit që ofron.</p> <p>Rekrutimi i personelit akademik i nënshtrohet praktikave të përcaktuara përkundrejt aplikimit me dosje dhe intervistës së personalizuar me të interesuarit.</p> <p>Vlerësimi i tyre bëhet i njehësuar kundrejt kritereve të përcaktuara. Kriteret përcaktohen nga DSHTM mbështetur në nevojat që paraqiten për realizimin e procesit mësimor dhe miratohen nga Rektori. Kandidatët vlerësohen dhe përzgjidhen sipas meritave nga komisioni <i>Ad-Hoc</i> i ngritur pranë departamentit.</p> <p>GVJ sic konstatoi dhe më lart vëren se, institucioni ndjek procedura ligjore të rregullta dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimin e personelit, mbështetur në Modalitetet për caktimin e kritereve dhe procedurave për punësimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik dhe kjo e mbështetur në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, LAL 80/2015S, dhe Statutin e Rregulloret e UAMD. Institucioni ka një strukturë të posaçme të emërtuar Zyra e Burimeve Njerëzore e cila ka krijuar një bazë të dhënash për personelin dhe vendet e lira të punës.</p>



	<p>Vëndi i lirë i punës shpallet në faqen zyrtare institucionit dhe Buletin e Njoftimeve Publike (APP). Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përfshira gjithashtu në Statutin e UAMD. Ndërkohë kriteret propozohen në varësi të vendit të lirë nga strukturat përkatëse (Drejtuesi i Departamentit). Një mënyrë vlerësimi i personelit akademik është aplikimi i pyetësorit të vlerësimit nga studenti e programit të studimit dhe përgjegjësi i departamenti.</p> <p>Pjesë e vlerësimit të stafit është edhe marrëveshja për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik në IAL-të publike ku përfshihen disa aspekte si: mësimdhënie; kërkim shkencor; kontribut institucional; kontribut profesional</p> <p>Dosjet e Personelit akademik qëndrojnë të arkivuara në zyrën e burimeve njerëzore në bazë të zbatimit të rregullores së arshivimit .</p> <p><i>EVIDENCA Nr. 15. Ngarkesa e plotë e stafit DSHTM.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr. 30. Plani mësimor dhe tabela e veprimtarive formuese.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr. 59. Procedura e rekrutimit.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr. 62. Cv stafi ndihmës akademik.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr. 61 'Rregullorja e arshivimit Nr141. Datë 27.09.2018'</i>  <i>EVIDENCA Nr.62 "CV-të e Stafit Ndihmës Akademik të DSHTM"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me drejtues të institucionit, takimin me stafin akademik dhe ndihmës akademik si dhe RVB, konstatoi se, pranë çdo njësie bazë ka të angazhuar Personel Ndihmës Mësimor, përgjegjës për mirëmbajtjen e ambienteve laboratorike dhe ambienteve të tjera mësimore. Të drejtat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës mësimor janë të parashikuara në rregulloren e institucionit. Në rang departamenti numërohen 2 (dy) personel ndihmës mësimor. Personeli ndihmës mësimor në bashkëpunim me pedagogët e lëndëve siguron mirëmbajtjen e kabineteve për kryerjen e laboratorëve, praktikave mësimore dhe bën grafik sipas orareve që të mos ketë mbivendosje të studentëve në të njëjtën orë. Performanca e tyre matet edhe me anë të pyetësorëve anonim që bëhen dy herë në vitë, para sezonit të çdo semestri, si dhe performancës vjetore që bëhet nga shefi i Departamentit.</p> <p><i>EVIDENCA Nr. 30. Plani mësimor dhe tabela e veprimtarive formuese.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr. 61 'Rregullorja e arshivimit Nr141. Datë 27.09.2018'</i>  <i>EVIDENCA Nr.62 "CV-të e Stafit Ndihmës Akademik të DSHTM"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislativon në</p>	<p>Bazuar në RVB, dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe takimit me drejtues të institucionit dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore në Universitetin e Aleksandër Mojsiu në Durrës u konstatua se Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNJ) është njësi e ngarkuar me përgjegjësinë direkte për ruajtjen e të dhënave të personelit drejtues, akademik dhe administrativ. Zyra e BNJ ruan dhe administron një informacion të hollësishëm për personelin. GVJ -së ju vunë në dispozicion nga Zyra e BNJ, të dhënat të depozituara në formë të printuar dhe një pjesë e tyre dhe në formë elektronike. Pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore gjendet i gjithë dokumentacioni në lidhje me stafin akademik, atij ndihmës dhe administrativ. Pranë zyrës së burimeve njerëzore depozitohen dosjet e PE , PAK të cilat përditësohen çdo fundviti me aktivitetin shkencor dhe CV-itë e vitit përkatës.</p>

<p>fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Dosja përmban (CV, fotokopje e ID, raporti mjko ligjor (I aftë për punë), lista e notave, diplomës, gradës, gjuhës së huaj të noterizuara, punime shkencore, dy referenca, vërtetim nëse ka qënë mësimdhënës, kontrata e lidhur me institucionin etj.</p> <p>Gjithashtu, koordinatori është personi përgjegjës për organizimin e veprimtarive për programin e studimit. Këshilli i kërkimit shkencor të UAMD ka krijuar një databazë për ruajtjen e të dhënave për punime shkencore të stafit akademik. UAMD ka hartuar dhe vijon të zbatojë një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>GVJ në tabelën e ngarkesë mësimore dhe performancën vjetore të stafit konstaon se i gjithë stafi akademik dhe ndihmës akademik është i përfshirë në mësimdhënie, si dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi.</p> <p><i>Evidencë Nr.30. Plani mesimor dhe tabela e veprimtarive formuese.pdf</i></p> <p><i>Evidencë Nr 37. Emerimi i koordinatorit te programeve te studimit DSHTM.pdf</i></p> <p><i>Evidencë Nr 40. Dosja e programit te studimit (kurrikula , plani mesimor, dhe personeli akademik).pdf</i></p> <p><i>Evidencë Nr 54. Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi dhe ju vunë në dispozicion marrëveshje të bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani si: marrëveshje e lidhur mes Përgjegjësit të DSHTM dhe personelit akademik për organizimin e kohës vjetore të punës; Rregullore e DSHTM, Organizimi akademik dhe administrativ i njësisë bazë, marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel Departamenti, Marrveshja e bashkëpunimit me klinikën fizio vision, Marrveshja e bashkëpunimit me Rotary Club; marrëveshje me Spitalin Rajonal Durrës, poliklinika Durrës etj</p> <p>Personeli akademik i institucionit mund të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, kryesisht përmes periudhave të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmus+, bashkëpunimeve me universitete e tjera si edhe përmes lektorëve të ftuar në kuadër të veprimtarive kualifikuese për stafin. . Marrveshje bashkëpunimi me universitete të huaja si : Hungari, Itali , Francë etj.</p> <p>GVJ bazuar në RVB, dokumentat si dhe vizita në institucion konstaton se FSHMT vë në dispozicion personel të mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale me institucionet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi sipas natyrës së programit të studimit dhe sipas Rregullores së Praktikës.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.21 "Rregullore e DSHTM, Organizimi akademik dhe administrativ i njësisë bazë, neni 14 Drejtuesi i njësisë bazë (Përgjegjësi i Departamentit), neni 15 Funksionet e drejtuesit të njësisë bazë, neni 16 Përgjegjësi i grupit mësimor dhe kërkimor-shkencor, neni 17 Koordinator i programit të studimit, Seksioni II Personeli akademik dhe administrativ i</i></p>



	<p><i>njësisë bazë nenet 18"</i>  <i>EVIDENCA Nr.63 "Rregullore për menaxhimin e aktivitetit kërkimor Shkencor të zhvilluara në UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.52 "Marrveshjet e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.23 "Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel Departamenti"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 138 'Marrveshja e bashkëpunimit me Rotary Club'</i>  <i>EVIDENCA Nr.27 "Rregullorja e praktikave Profesionale dhe laboratorëve"</i>  <i>EVIDENCA Nr.23 "Marrëveshje e Bashkëpunimit të DSHTM"</i>  <i>EVIDENCA Nr.65 "Marrëveshja e bashkëpunimit me klinikën fizio Vision"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Kriter 8.</b>          Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në takimin me stafin dhe me studentët GVJ u informua se, në kuadër të realizimit të praktikave klinike, UAMD dhe FSHMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me qëndra spitalore universitare, poliklinika dhe klinika private fizioterapie. Pedagogët përgjegjës për mbarëvatjen e ktyre praktikave në bashkëpunim me stafin e qëndrave, ndihmojnë studentët në asimilimin sa më korrekt teorik e praktik të lëndëve praktikë 1, 2, 3. Studentët priten në institucionete e kontraktuara nga mbikqyrësi (tutori i praktikës) dhe në fund të praktikës, mbikqyrësi i praktikës plotëson një formular mbi performancën e studentit gjatë orëve të praktikës. Ky formular i plotësuar dhe firmosur i dorëzohet koordinatorit i cili ja jep komisionit i cili do të vlerësoj studentin për praktikën. Provimi është me gojë dhe vlerësohet me notë sipas syllabusit të lëndës. Prapakisht studentit i jepet programi i temave të praktikës.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.27 "Rregullorja e praktikave Profesionale dhe laboratorëve"</i>  <i>EVIDENCA Nr.65.1 Model i plotësimit të një rasti klinik.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr.66.1 silabus praktika profesionale IV.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr.66.Udhëzimi koordinatorit për vlerësimin e provimit final.pdf</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se ky standart "plotësohet plotësisht" pasi personeli akademik që mbulon programin e studimit, PAE-PAK përmbush standardet sasiore dhe kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit, por sygjerojmë të bëhet e mundur rekrutimi i PAE me grada dhe trajnime përkatëse për lëndët profesionale për programin Bachelor në Fizioterapi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ gjatë guidës në institucion vuri re se ky Institucion ka hapsirat e nevojshme për zhvillimin sa më bashkëkohor të programit mësimor si: Sallat e leksioneve, të seminareve, laboratorët, biblioteka, etj. Hapësirat mësimore janë pajisur me infrastrukturën e nevojshme didaktike për zhvillimin e leksioneve, seminareve, laboratorëve dhe orëve praktike. Sallat e leksioneve janë pajisur me PC dhe projektor për prezantimin e leksioneve me Poëer Point, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.Tabela 16 - Ambientet e FSP.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr.68 "Inventar i laboratorit të Fizioterapisë"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Laboratorët e posaçëm të rehabilitimit dhe të fizioterapise janë pajisur secili me pajisjet me të fundit të nevojshme për një mësimdhënie sa më interaktive dhe bashkëkohore. Gjithë kjo infrastrukturë është realizuar edhe në vazhdimësi falë dhe rikonstruktruksionit përgjatë viteve në bazë të specifikave të programeve të studimit që ofron, i cili garanton infrastrukturën e nevojshme dhe cilësore për procesin e mësimdhënies.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.Tabela 16 - Ambientet e FSP.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr.68 "Inventar i laboratorit të Fizioterapisë"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ gjatë guidës në institucion vuri re se: Laboratorët e ndryshëm si ai i anatomisë, laboratorit i fizioterapisë, laboratorit i rehabilitimit, laboratorit i fiziologjisë, janë të pajisur me pajisjet e nevojshme për zhvillimin e një procesi mësimor që përmbush objektivat formuese të lëndës specifike dhe të programit të studimit në përgjithësi. GVJ gjatë vizitës në laboratorin e fizioterapisë konstatoi se ishin të pajisur me aparatura bashkëkohore për të realizuar sa më cilësisht orët e praktikave dhe të laboratoreve. GVJ konstatoi se çdo zyrë disponon të paktën një projektor, printera dhe fotokopje për t'i ardhur në ndihmë lektorëve dhe studentëve për çdo nevojshmëri që ata kanë për mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.Tabela 16 - Ambientet e FSP.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr.68 "Inventar i laboratorit të Fizioterapisë"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe bazuar në RVB konstatoi se, institucioni ka një laborator të informatikës (IT) i pajisur me kompjutera me parametra teknike të standardeve bashkëkohore, ku janë instaluar të gjithë programet e nevojshme për të mundësuar zbatimin e programeve. Programet: Paketa Office, Softëare për përpunimin statistikor të të dhënave. Studentët e Fizioterapisë kanë mundësi të realizojnë detyrat e kursit, të bëjnë praktika të ndryshme, si dhe aktivitete trajnuese në këtë laborator. Ky laborator ndihmon pedagogët/studentët të realizojnë punën e tyre kërkimore-shkencore dhe është në dispozicion gjatë gjithë orarit të punës</p>

	<p><i>EVIDENCA Nr. 78. Licensimi i programeve kompjuterike.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr. 79. Rregullore e Sektorit te Teknologjise se Informacionit.pdf</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konkludon UST vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatura me fushën e programit të studimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</b></p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, RVB, vizitën në institucion, takimin me stafin dhe studentët u informua se: Studentët kanë në dispozicion tekste dhe literaturë shtesë të cilat përditësohen vazhdimisht. Pedagogët çdo vit përditësojnë ciklin e leksioneve dhe e depozitojnë atë në Departamentin përkatës, marrin miratimin dhe i depozitojnë fizikisht këto cikle leksionesh.</p> <p>UAMD ka akses edhe në disa biblioteka online Elibrary, ku studentët mund të lexojnë dhe të shkarkojnë shumë libra dhe punime shkencore sipas udhëzimeve të pedagogëve të lëndëve dhe linkut që atyre ju jepet dhe sipas <i>Manual për përdorimin e bibliotekës digjitale.</i></p> <p>Në bibliotekë ka një numër të madh librash dhe literaturë si në format të shtypur edhe në formë elektronike për lëndët e formimit të përgjithshëm -bazë, <i>por mungon literaturë fizikisht shqip dhe në gjuhë të huaj për lëndët profesionale në bibliotekë.</i> Librat të cilat janë kryesisht në dy gjuhë, anglisht dhe shqip, janë të grupuara sipas tematikave.</p> <p><i>EVIDENCA Nr. 70. Lista e teksteve dhe literaturë e rekomanduar për programin e studimit bachelor në Fizioterapi.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr. 71. Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr. 72. Info për bibliotekën UAMD.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr. 73. Strategji-Biblioteka.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 74. Rregullorja e Bibliotekës.pdf</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 76. Lista e Teksteve në Bibliotekën e UAMD.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr. 77. Biblioteka Online (manual).pdf</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me stafin dhe drejtues të institucionit u informua se DSHTM në fillim të çdo viti akademik rishikon syllabuset elëndëve të programeve të studimit që ofron, ku paraqet edhe literaturën bazë dhe të rekomanduar, të përditësuar, kryesisht të 5 viteve të fundit. Ndryshimet paraqiten nga titullari /pedagogu i lëndës.</p> <p>Në çdo vit në plan buxhetin e institucionit planifikohet edhe fondi për pasurimin e bibliotekës me libra dhe literaturë të 5 viteve të fundit.</p> <p><i>EVIDENCA Nr .70. Lista e teksteve dhe literautura e rekomanduar për programin e studimit bachelor në Fizioterapi.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr .71. Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr .75. Model sillabus rehbailitim në neurologji.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr.76. Lista e Teksteve në Bibliotekën e UAMD.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr.77. Biblioteka Online (manual).pdf</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe dokumentave përkatëse të bibliotekës konstatoi se; biblioteka e UAMD-së është një hapësirë brenda mjediseve të universitetit. Përveç se hapësirë leximi, biblioteka mund të shfrytëzohet nga studentët edhe për infrastrukturën kompjuterike përgjatë ditës në funksion të realizimit të detyrimeve të programit të studimit. Gjithashtu biblioteka ka edhe një rregullore me anë të së cilës tregohen të gjithate drejtat dhe detyrimet që ajo ka për studentët e universitetit.</p> <p><i>EVIDENCA Nr .74. Rregullorja e Bibliotekes.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr .76. Lista e Teksteve në Bibliotekën e UAMD.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr .77. Biblioteka Online (manual).pdf</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ sic theksuam dhe më lartë, gjatë vizitës në institucion, konkretisht në bibliotekë konstatoi se biblioteka është e pajisur me literaturë fizike, si: cikle leksionesh, tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, për lëndët e formimit bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) 15% - 20% e programit rreth 28 kredite , lëndë ndërdisiplinore/ integrale – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) 12% - 15% (22 kredite = 12%), lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, të programi bachelor në fizioterapi, por në bibliotekë mungojnë librat fizik në gjuhën shqipe apo të huaj për lëndët profesionaleCiklet e leksioneve dhe librat profesional ishin të depozituara në departament sic na u referua gjatë vizitës në institucion si ( rehabilitimi në neurologji , rehabilitimi në neuropsikologji, rehabilitimi në ortopedi). GVJ duke ditur që lëndë karakterizuese -profesionale – përgatitje për</p>





	<p>disiplinën shkencore (B) 50% - 55% të programit të tre viteve dhe e shprehur në kredite përbëjnë (98 kredite = 54%), mendon se janë pak dhe <i>sygjeron të shtohen librat profesional të programit Bachelor në Fizioterapi, në bibliotekë dhe të mos ruhen vetëm në departament.</i></p> <p>GVJ gjithashtu konstaton se , 70% e ngarkesës së programit është realizuar me lektorë të brendshëm me grada e tituj shkencorë, duke patur parasysh Literaturat bazë dhe ato të detyrueshme janë të pranishme në çdo syllabus të lëndëve të programit të studimit,</p> <p>Aktiviteti i bibliotekës rregullohet me anë të rregullores përkatëse, biblioteka në UAMD qëndron e hapur edhe në fundjavë për t'u shërbyer sa më mirë studentëve dhe stafit akademik.</p> <p><b><i>GVJ sygjeron të shtohen librat profesional të programit Bachelor në Fizioterapi, në bibliotekë dhe të mos ruhen vetëm në departament.</i></b></p> <p><i>EVIDENCA Nr .74. Rregullorja e Bibliotekes.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr .76. Lista e Teksteve në Bibliotekën e UAMD.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr .77. Biblioteka Online (manual).pdf</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ u informua se institucioni ka ofruar kushte për bibliotekën on line. U-Library, biblioteka online e ofruar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Universitetet publike shqiptare dhe Rrjetin Akademik Shqiptar është një platformë elektronike ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të aksesojnë, shkarkojnë libra mësimore në format pdf, të aksesojnë, shkarkojnë artikuj shkencore, revista shkencore, etj.</p> <p>Studentët e pedagogët mund ta aksesojnë këtë bibliotekë pa pagesë përmes adresës së emailit të siguruar nga institucioni.</p> <p><i>EVIDENCA Nr .79. Rregullore e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr .80. Korrespondenca shkresore midis Bibliotekave dhe fakultetit.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr .81.Lista e paketave U-Library.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr .82.Lista e teksteve që gjenden fizikisht për programin e studimit bachelor në fizioterapi.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr .83.Rregullore DASHA sektori komunikim, ALUMNI.pdf</i> Vizita në institucion</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Në takimin me studentët dhe stafin akademik, inspektimit të ambienteve të bibliotekës GVJ konstatoi se Biblioteka e UAMD-së është e pajisur me PC, të lidhur në rrjetin LAN që mund të përdoren nga studentët për të kërkime të mëtejshme në fushën e tyre të studimit, për të marrë materiale didaktike nga pedagogët e tyre, të hedhura në rrjetin e brendshëm.</p>

	<p>Institucioni ofron mundësi botimi në revistën e universitetit dhe krijon mundësi aksesimi për të gjithë studentët për të publikuar online dhe për të studjuar botimet që bëhen në to. Specialistët e sektorit të IT janë vazhdimisht në ndihmë të bibliotekës duke respektuar nenet 1 deri në 5 të Rregullores së IT.</p> <p>Biblioteka e UAMD është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> <p><i>EVIDENCA Nr .79. Rregullore e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit.pdf</i> <i>EVIDENCA Nr .80. Korrespondenca shkresore midis Biblioteka dhe fakultetit.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr .81.Lista e paketave U-Library.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr .82.Lista e teksteve që gjenden fizikisht për programin e studimit bachelor në fizioterapi.pdf</i>  <i>EVIDENCA Nr .83.Rregullore DASHA sektori komunikim, ALUMNI.pdf</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ në takimin me studentët dhe stafin akademik, inspektimit të ambienteve të bibliotekës konstatoi biblioteka funksionon sipas një orari të paracaktuar, me grafik, i cili afishohet në vende të dukshme, hidhet on-line në faqen zyrtare dhe informohen studentët. Orari i Bibliotekës është 08:00 - 20:00 nga dita e hënë deri ditën premte, sipas nevojave punohet edhe për fundjavë. Biblioteka e UAMD shfrytëzohet stafi akademik dhe nga studentët e të gjitha cikleve të studimit, pasi përkon me oraret e tyre të mësimi.</p> <p>Ditet e pushimit, festive zyrtare nuk funksionon biblioteka fizike por on line në linkun U library.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.74 "Rregullorja e përdorimit të bibliotekës në fundjavë"</i>  <i>EVIDENCA Nr. 80 "Korespondenca shkresore e bibliotekës me Rektoratin-Fakultetet për përditësimin e fondeve"</i>  <i>EVIDENCA Nr. 82 "Lista e teksteve dhe cikleve të leksioneve të programit të Studimit bachelor në Fizioterapi"</i>  <i>EVIDENCA Nr. 81 "Lista e paketave u/library"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë</p>	<p>GVJ në takim me drejtues të institucionit, me studentët, me stafin akademik, me punonjësit e bibliotekës si inspektimit të ambienteve të bibliotekës vuri re se sallat e studimit kanë një frekuentim të lartë e të vazhdueshëm si nga stafi akademik, ashtu dhe nga studentët. Kjo evidentohet me përdorimin e përditshëm të fondit të literaturës së vënë në dispozicion</p> <p>UAMD ka hartuar dhe zbaton një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programeve të studimit Në mënyrë sistematike sipas syllabusit të lëndëve, kërkohet nga</p>

<p>përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>pedagogët që të gjitha leksionet, librat apo botime të tjera të depozitohen, minimalisht nga një kopje në bibliotekë dhe në departament. Në mënyrë të përvitshme, nëpërmjet plan buxhetit kërkohen titujt e librave apo botimeve specifike për çdo program studimi. Biblioteka universitare punon sipas standardeve ndërkombëtare dhe udhëzimeve të përcaktuara nga IFLA (Federata Ndërkombëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Bibliotekave dhe Institucioneve ) dhe politikave të brendshme të vetë bibliotekës.</p> <p><i>EVIDENCA Nr. 80 “Korespondenca shkresore e bibliotekës me Rektoratin-Fakultetet për përditësimin e fondeve”</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 82 “Lista e teksteve dhe cikleve të leksioneve të programit të Studimit bachelor në Fizioterapi”</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 81 “Lista e paketave u/library”</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ mendon se biblioteka e UAMD zotëron literaturë fizike dhe on line të nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies për lëndët e formimit bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme lëndë ndërdisiplinore/ integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje ,lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, të programi bachelor në fizioterapi , por në bibliotekë janë pak ose mungojnë libra , literaturë për lëndët karakterizuese - profesionale, në këto kushte <b>GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht por sygjeron të shtohen librat profesional të programit Bachelor në Fizioterapi, në bibliotekë .</b></i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore u informua se, institucioni disponon sistem të menaxhimit dhe administron të gjithë informacionin e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim përmes sistemit PITAGORA në formë elektronike, por dhe me anë të regjistrave nga momenti I regjistrimit deri në përmbylljen e plotë të programit të studimeve Bachelor. Sistemi i PITAGORËS është një program informatik që ruan, administron, dhe përpunon të dhënat e studentit, dhe rekordet akademike ndër vite i cili ofrohet në bashkëpunim me RASH me kontratë pa limit. Me anë të sistemit PITAGORA studentët</p>

	<p>aksesojnë infomacione të ndryshme që lidhen me të dhënat e tyre përgjatë kohës së studimit.</p> <p>Gjithashtu administrimi i informacionit të brendshëm kryhet nga platforma on-line U-TRANSPARENCA, i cili është në bashkëpunim me AKSHI-n, me një kontratë pa limit.</p> <p>Sekretaria mësimore administron të gjithë informacionin që lidhet me të dhëna të detajuara për studentët që regjistrohen (gjeneralitete etj.) mbështetur në Rregulloren e Sekretarisë mësimore, në të cilën tregohen qartë të gjitha procedurat në të cilat kalon informacioni që lidhet me studentët nga regjistrimi e deri në diplomimin e tyre.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.86 "Manual i përdorimit të sistemit Pitagora nga studentët dhe pedagogët"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.87 "Sistemi i integruar i menaxhimit AULA\Pitagora – personeli akademik"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.84 "Rregullorja e sekretarisë mësimore"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, takim me stafin e IT- së, studentët dhe stafin akademik të institucionit konstatoi se, sistemi për Menaxhimin e Informacionit PITAGORA është i aksesueshëm edhe nga personeli akademik që e përdor atë për aktivitetin në kuadër të procesit të mësimdhënies; i mundëson studentit të përditësohet në kohë reale me të dhënat që pedagogu hedh në sistem si vlerësime, frekuentim, program/silabe dhe komunikime në formë mesazhesh tekst.</p> <p>Institucioni është në proces të implementimit të një arkive digjitale për administrimin e dokumentacionit të të gjitha drejtorive të UAMD-së, të cilat do të administrojnë aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Aktualisht drejtoritë funksionojnë përmes krijimit të bazave të të dhënave lokale, në format Word dhe Excel.</p> <p><i>(Ref. 41. Aksesi online në systemin PITAGORA)</i></p> <p>Po ashtu, GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se sistemi aktual i Menaxhimit të Informacionit ofron funksionalitetet e nevojshme për stafin akademik, administratën (sekretarinë mësimore) dhe studentët për administrimin e të gjithë ciklit akademik të studentit: si regjistrimi i program/syllabus të kurseve, vlerësimet deri në diplomim, gjithashtu transferimet nga njëri universitet në tjetrin. <u>Funksionalitetet didaktike</u> përfshijnë: strukturën akademike, menaxhimin e karrierës së studentit si dhe administrimin e provimeve dhe diplomimin. <u>Funksionalitetet për sekretarinë</u> përfshijnë: pranimin dhe regjistrimin, menaxhimin e studentëve hyrës dhe dalës. <u>Funksionalitetet për aspektet financiare</u> të programit</p>



	<p>të studimit përfshijnë: menaxhimin e tarifave; bursat; periudhat financiare etj.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.86 "Manual i përdorimit të sistemit Pitagora nga studentët dhe pedagogët"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.87 "Sistemi i integruar i menaxhimit AULA\Pitagora – personeli akademik"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.84 "Rregullorja e sekretarisë mësimore"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.88 "Rregullorja e Burimeve Njerëzore, UMAD"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.83 "Rregullores së zyrës së Alumnit dhe Karrierës"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë guidës në institucion, në takimet e realizuara me stafin, studentët, sekretarinë, IT etj u referua se funksionet e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit është komunikimi dhe shkëmbimi i materialeve didaktike dhe informacionit në formë njoftimesh mes pedagogut dhe studentëve.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.83 "Rregullores së zyrës së Alumnit dhe Karrierës"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Në takimin me drejtues të institucionit dhe punonjësit e IT, u informuam se, sistemi i Menaxhimit të Informacionit siguron monitorimin e mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, sidomos në lidhje me administrimin e provimeve dhe hedhjes së vlerësimeve. Kjo i kontribuon shmangies së vonesave dhe rritjes së transparencës. Nga ana tjetër, pedagogët mund të përdorin të dhënat e hedhura në sistem për përpunime të mëtejshme statistikore. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Çdo lektor përpara fillimit dhe pas mbarimit të orës mësimore është i detyruar të marrë rregjistrin dhe të firmosë listë-prezencën, e cila shërben si element për kontrollin e pranisë së lektorëve gjatë orës së mësimi.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.83 "Rregullores së zyrës së Alumnit dhe Karrierës"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, takimit me stafin, studimin e RVB konstaton se, institucioni ka në administrim faqen zyrtare <a href="http://ëëë.uamd.edu.al">ëëë.uamd.edu.al</a> të cilat janë në përputhje me politikat e transparencës dhe politikat e privatësisë sipas legjislacionit në fuqi. Përmbajtja e faqes ofrohet në gjuhën shqipe dhe anglisht. Platforma e U-Transparencës është një tjetër hapësirë elektronike ku shfaqet informacioni dhe vendime të ndryshme të institucionit. Llogaritë në rrjetet shoqërore janë gjithashtu mundësi informimi për njoftime të ndryshme, që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme. Gjithashtu në shumë raste informuese sekretaria është zëvendësuar nëpërmjet aksesit të informacionit te</p>

	<p>faqja zyrtare e universitetit ëëë.uamd.edu.al, përmes Facebook-ut në të cilat publikohen të gjitha informacionet që studentët të kenë mundësi të aksesojnë informacionin edhe në distancë, pa qenë e nevojshme të jenë të pranishëm në fakultet.</p> <p>Po kështu GVJ konstaton se në faqen e internetit janë të aksesueshme: short bio-t, kurrikulat, programet e studimit, aktivitete të ndryshme dhe njoftime të tjera të përditësuara në platforma të ndryshme elektronike.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.94 "www.uamd.edu.al"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.96 "Faqja zyrtare e universitetit UAMD në FB" EVIDENCA Nr.96 "Faqja zyrtare e Fakultetit të Studimeve Profesionale në Facebook"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ bazuar në RVB, dokumentat e vëna në dispozicion si dhe guidën në institucion mendon se UAMD, disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, RVB, takimi me drejtues të njësisë kryesore dhe takimi me punonjësit e zyrës ekonomike, konstatoi se ekziston një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare, si dhe informacionet mbi të ardhurat nga studentët. Raporti financiar përmban informacion për mbulimin e shpenzimeve në nivel institucional I cili hartohet mbi bazën e kostove dhe financimeve. Tek financimet hyjnë granti i akorduar nga pushteti qendror dhe fondet jopublike. Granti i akorduar është i plotë dhe siguron financim për të gjithë programin e studimit BA, duke mbuluar kostot deri në përfundim të programit. Institucioni bazuar dhe në udhëzimet e MAS, garanton bursa për studentët exelentë, po ashtu për studentët me prindër invalid ose ndihmë ekonomike. Shpenzimet për program të dytë studimi mbulohen nga tarifat e shkollimit. Të ardhurat e gjeneruara nga institucioni në formë tarifash shkollimi, donacionesh, sponsorizimesh, etj., shkojnë gjithashtu në mbështetje të programit të studimit duke siguruar infrastrukturë mbështetëse për procesin mësimor, si hapësira, mjete, pajisje e të tjera si këto. Institucioni bazuar dhe në udhëzimet e MAS, garanton bursa për</p>

	<p>studentët exelentë, po ashtu për studentët me prindër invalid ose ndihmë ekonomike. Institucioni po ashtu mbështet financiarisht dhe pedagogët për kërkim shkencor edhe/ose publikim artikujsh dhe pjesmarrje në konferenca shkencore.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.97 "Përdorim i të ardhurave i UAMD</i>  <i>EVIDENCA Nr. 98 'Plani financiar në nivel Institucional'</i>  <i>EVIDENCA Nr.38 "Udhëzimi nr.31, dt.29.12.2017"</i>  <i>EVIDENCA Nr.99 "Plani Financiar Vjetor i Fakultetit të Studimeve Profesionale"</i>  <i>EVIDENCA Nr.100 "Të dhëna nga Plani i financimit të programit të studimit"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Bazuar në RVB, takim me drejtuesit e njësisë kryesore GVJ, u informua se në cdo fillim viti financiar bëhet plani i financimit nga njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Ky plan financiar duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore për realizimin e programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, materiale dhe pajisje laboratorike etj. Ky plan i dërgohet Senatit të Universitetit nga njësia kryesore, Senati Akademik miraton propozimin e Rektoratit për detajimin e grantit të pushtetit qendror për vitin në vazhdim, dhe ia kalon ato më pas Bordit të Administrimit për miratim. Bordi i Administrimit nga ana e tij miraton detajimin e grantit dhe ngarkon Administratorin dhe Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e tij. Aktualisht plani i financimit hartohet në nivel institucional. Është duke u punuar që në të ardhmen të hartohen plane financimi në rang programi studimi</p> <p><i>EVIDENCA Nr.99 "Plani Financiar Vjetor i Fakultetit të Studimeve Profesionale"</i>  <i>EVIDENCA Nr.100 "Të dhëna nga Plani i financimit të programit të studimit"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ u informua nga drejtuesit e institucionit se institucioni harton pasqyra financiare të hollësishme brenda afateve të parashikuara për deklarimin e dorëzimit të pasqyrave financiare. Këto i dërgohen për miratim ministrisë përgjegjëse për arsimin. I gjithë aktiviteti financiar i institucionit, përfshirë edhe pasqyrat financiare, është subjekt auditimi nga ministria përgjegjëse për arsimin. Misioni i auditimi konsiston në auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme, auditimin e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit, auditimin e krijimit dhe menaxhimit të të ardhurave, etj. Institucioni me marrjen e raportit të auditit merr masa për hartimin e një plan veprimi me qëllim implementimin e rekomandimeve dhe sugjerimeve të grupit të auditit. Raporti i auditit i përcillet edhe Bordit të Administrimit.</p>

	<p>Auditet në përgjithësi bëhen nga MAS, të cilat bëhen pothuaj çdo vit për infrastrukturën dhe financat, por dhe vetë UAMD bën çdo vit një kontroll nga zyra e auditit të brendshëm të kryer dhe drejtuar nga Këshilli i Administrimit. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjëndjen e financimit dhe efektivitetin financiar, një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare, informacion nga pyetëtori i vetëvlerësimit për njësitë e auditimit të brendshëm, struktura e raportimit vjetor etj.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.97 "Përdorim i të ardhurave i UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.98 "Raport Finaciar dhe përdorimi i të ardhurave"</i>  <i>EVIDENCA Nr.101 "Veprimtari Audituese"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ u informua nga drejtuesit e institucionit se institucioni dorëzon në mënyrë periodike pasqyrat financiare në nivel institucional, ende jo në nivel programi. Planit financiar i hartuar parashikon diversifikimin e planit të financimit me qëllim që të garantojë vazhdimësinë e ofrimit të programeve të studimit. GVJ konstatoi se, në mes dhe në fund të një programi studimi, institucioni rishikon koston e një programi studimi, që mund të rezultojë në një ndryshim eventual të financimit. Pjesë e raportit financiar të UAMD është dhe veprimtaria e FSP dhe e DShTM lidhur me kostot financiare të programin e studimit Bachelor në "Fizioterapi". Gjithashtu edhe përballë situatave të paprashikuara, përmes ndërhyrjeve të posaçme, institucioni dëshmon aftësi për garantimin e ecurisë së një programi studimi.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.97 "Përdorim i të ardhurave i UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.98 "Raport Finaciar dhe përdorimi i të ardhurave"</i>  <i>EVIDENCA Nr.101 "Veprimtari Audituese"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB si dhe takimin me drejtuesit e institucionit se Universiteti "Aleksandër Moisiu" dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare jo vetëm përgjatë kohës së zhvillimit programit bachelor në Fizioterapi, por edhe për zhvillimin e programeve të tjera të studimit që ofron ky institucion. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. Të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.97 "Përdorim i të ardhurave i UAMD"</i></p>



	<i>Vizita në institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion dhe referencat përkatëse, mendon se institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ gjatë bashkëbisedimit me drejtues të institucionit, studentët, koordinatorin e programit, sekretarinë mësimore, RVB, konstatoi se ky institucion harton politika dhe procedura të sakta gjatë vitit akademik të studentëve (në hyrje dhe në përfundim të studimeve), në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi. Ndiqet një radhë pune si më poshtë: në bazë të Dekreteve të nxjerra çdo vit nga Ministria Shqiptare e Arsimit, Sportit dhe Rinisë procesi i pranimeve në UAMD organizohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Pranimi në këtë program studimi është me numër të caktuar kuotash. Çdo vit senati i UAMD miraton kuotat e pranimit, kriteret e pranimit, vendet e disponueshme, për të gjitha kategoritë dhe publikohen në faqen e internetit të institucionit. Për sa më sipër kuotat për cdo kategori studentësh caktohen çdo vit dhe publikohen në faqen e internetit nëpërmjet njoftimeve të pranimit sipas Ligjit të Arsimit të Lartë në Shqipëri Nr. 80/2015 si dhe dhe dekreteve e vendimeve të nxjerra çdo vit nga Ministria Shqiptare e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të cilat përcaktojnë procedura të regjistrimit dhe afatet përkatëse. Një kopje e këtyre vendimeve të Senatit Akademik në formë shkresore-letër dhe në formë elektronike dërgohet në MASR Procedurat e pranimit bëhen të njohura në faqen zyrtare të UAMD me anë të shpalljeve dhe njoftimeve të pranimit, të cilat përmbajnë informacione të hollësishme për vendet e disponueshme dhe kriteret e pranimit. Po ashtu në kuotat e pranimit, ka kuota të caktuara jo vetëm për shtetas të Shqipërisë dhe vendeve jo nga BE, kuota për transferime, të gjithë studentët të cilët duan të regjistrohen në

	<p>UAMD paracaktohen dhe miratohen nga senati. Kriter që duhet të plotësoj studenti është që të jetë me maturën shtetërore dhe not mesatare sa më të lartë .Studentët nga hyrja deri tek diplomimi i tyre është i rregulluar në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi të ardhura nga MAS, rregullores dhe statutit të institucionit, rregullores së fakultetit dhe rregullores së programit të studimit, të hartuara e të përditësuara vazhdimisht në përputhje të këtij legjislacioni. Institucioni dhe njësia përgjegjëse për ofrimin e programit kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.04 "Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80,2015"</i>  <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.11 "Statutit të Universitetit"</i>  <i>EVIDENCA Nr.103"Vendim Nr. 10 datë 07.04.2017 Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë UAMD"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore GVJ vuri re se ky institucion bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Shqiptar, nr. 80/2015, statutin e UAMD siguron barazinë bazuar mbi kriteret dhe procedurat për të gjithë kandidatët për tu regjistruar në Programin e Studimit të Diplomës "Bachelor" në Fizioterapi. Në takimin me sekretarinë konstatoam se ekzistonin regjistra të cilat tregonin të gjithë praktikën e regjistrimit apo të ç' regjistrimit të studentëve fitues sipas kriterëve dhe portalit të studentit, pa bërë dallime se kujt i përkisnin këto kuota (student shqipëtar, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Bosnjë- Hercegovinës). Gjithashtu UAMD sipas legjislacionit në fuqi, neni 89, Ligji i arsimit të lartë Nr. 80, Viti 2015; Statutit të UAMD, Rregullores së UAMD për procedurën e pranimeve, transferimeve dhe aplikimeve për programin e parë të studimit, bachelor në Fizioterapi, si dhe ekuivalentim me Vendim departamenti ngre një komision vlerësimi për student nga Universitete të tjera.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.04 "Ligji i arsimit të lartë Nr. 80, Viti 2015"</i>  <i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"283</i>  <i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullore e NJSBC"</i>  <i>EVIDENCA Nr.42 "Kriteret për transferim dhe ekuivalentim studimesh"</i>  <i>EVIDENCA Nr. 105 "Praktika shkresore MAS-UAMD-FSP për publikimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit të studentëve për vitin 2021-2022"</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p><i>Vizita në institucion</i></p> <p>GVJ në takimin me stafin pedagogjik dhe studentet si dhe dokumentat e vëna në dispozicion, GVJ u informua dhe konstatoi se, para çdo viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR organizohen “ditët e informimit të maturantëve” në gjimnazet kryesore të qarkut Tiranë dhe qarqet fqinje të cilat përbëjnë burimin kryesor të studentëve që ndjekin studimet në FSHTM. Stafi i ngarkuar për informim organizon takime, shpërndan fletëpalosje ku sqarohen të interesuarit me informacionin e nevojshëm për kriteret e pranimit apo për çështje të tjera të lidhura me të.</p> <p>Nga ana tjetër kriteret e përgjithshme dhe ato specifike janë lehtësisht të aksesueshme në ëeb e UAMD. Kriteret dhe procedurat përkatëse për ofrimin e programit të studimit janë hartuar në mënyrë që të jenë të kuptueshme, dhe njëkohësisht të aksesueshme, çka i jep procesit transparencë të plotë. Kriteret dhe procedurat janë të aksesueshme online, i bëhen të ditura të interesuarve në zyrën e sekretarisë mësimore në oraret e përcaktuara për sqarime dhe shërbime dhe gjatë këshillimit e orientimit të ofruar nga zyra përgjegjëse në rang fakulteti e institucioni. Në fillim të çdo viti akademik realizohet procedura e regjistrimit dhe transferimit të studentëve sipas udhëzimeve dhe legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Website i programit të studimit. <u>Bachelor – UAMD</u></i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.42 “Kriteret për transferim dhe ekuivalentim studimesh”</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 105 “Praktika shkresore MAS-UAMD-FSP për publikimin e kriterëve dhekuotave të pranimit të studentëve për vitin 2021-2022”</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni vëren se kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, transferimi, njohja e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku pasi janë të përcaktuara në rregulloret e studimit të Fakultetit dhe departamentit si dhe online në <i>Ëeb site i programit të studimit. <u>Bachelor – UAMD</u></i>, po ashtu informacioni rreth këtyre procedurave studentët informohen nëpërmjet sekretarisë mësimore, afishimit në ambjentet e fakultetit, në faqen e internetit, rrjetet sociale, lajmërimet përmes email-it etj.</p> <p>Gjatë intervistës me studentët u konfirmua se institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të tyre. Informacioni është i aksesueshëm nga burime si: sekretaria mësimore, faqja zyrtare (sistemi EMS) dhe QSHA, që japin informacione për çështje të ndryshme: procedurat e pranimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, vlerësimit të diplomimit</p> <p>Pranimi i studentëve në programin e studimit bëhet sipas kriterëve të caktuara më parë bazuar në “Ligji i arsimit të lartë” Nr. 80, Viti 2015 ,Rregullores së UAMD , Statutit të Universitetit; Rregullores së Fakultetit të Studimeve</p>

	<p>Profesionale.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.04 "Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, Viti 2015"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua se përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni merr pjesë në fushatat e informimit të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (open day) E gjithë procedura që nga aplikimi deri te pranimi i studentëve është publike dhe e aksesueshme në ëbsite-n e institucionit. Përpara fillimit të çdo viti akademik, të interesuarit informohen në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, përmes portalit U albania dhe faqes zyrtare të univesitetit.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.04 "Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, Viti 2015"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.42 "Kriteret e Pranimi të Studentëve, në departamentin e DSHTM"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konkludon se institucioni parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara</p> <p><i>EVIDENCA Nr. 106 "Rregullore për trajtimin e studentëve me aftësi të kufizuara në UAMD"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ, gjatë vlerësimit konstatoi se UAMD harton dhe publikon kriteret dhe kuotat dhe përzgjedhjen për kandidatët nga shtetet e tjera, si, Kosova, Preshevë-Bujanovca, Maqedonia e Veriut, Serbia e Mali i Zi dhe nga vende të tjera, nëse kandidatët zotërojnë gjuhën shqipe.</p> <p>Institucioni informon përmes faqes zyrtare kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera përmes kuotave të veçanta.</p> <p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, (çdo qershor) institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programeve të studimit që ofron nëpërmjet informimit në shkollat e mesme (open day).</p> <p>Institucioni para çdo viti akademik në janar planifikon kuotat sipas programit, infrastrukturës së institucionit, numrit të stafit akademik pas propozimeve nga dekanati , kalojnë në rektorat dhe miratohen në senat dhe dërgohen për miratim në MAS.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.04 "Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, Viti 2015"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 105 "Praktika shkresore MAS-UAMD-FSP për publikimin e kriterëve dhekuotave të pranimi të studentëve për vitin 2021-2022"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>



<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni, takimi me stafin, sekretarinë mësimore, zyrën e burimeve njerëzore, konkludon se në fillimin e çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse të ndihmës ekonomike dhe bursave për shtresat në nevojë, sipas udhëzimeve të ardhura nga MAS si dhe me vendim të Bordit të Administrimit UAMD.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.04 "Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, Viti 2015"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 105 "Praktika shkresore MAS-UAMD-FSP për publikimin e kritereve dhe kuotave të pranimit të studentëve për vitin 2021-2022"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion mendon se UAMD harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Fizioterapi. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të ëeb si dhe takimit me përfaqësues të tij, GVJ konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore. Gjatë takimit me studentët GVJ konstatoi se ata njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformës online Pitagora.</p> <p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve si dhe mundësinë e transferimit të studimeve, instrumentat e realizimit të vlerësimit të njohurive për lëndë të ndryshme, komponentët përbërës të vlerësimit total të lëndës, organizimi i provimeve, realizimi i praktikave, diplomimi, ndërpreja dhe rifillimi i studimeve, etj.</p> <p>Studentët informohen edhe nëpërmjet posterave dhe takimet në ditët e hapura me maturanët. Po ashtu në ditën e parë të fillimit të vitit akademik studentët realizojnë takim me drejtues të fakultetit si dhe pedagogë ku ata kanë mundësinë të njohin infrastrukturën, auditorët, të drejtat dhe përgjegjësië, programin e studimit dhe modulet përkatëse etj. Institucioni vë në dispozicion sekretarinë mësimore, Studenti akseson ecurinë akademike përmes llogarisë së tij në platformën Pitagora, ku ruhen të dhënat akademike ndër vite dhe</p>

	<p>studenti informohet për procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.21 "Rregullorja e DSHTM"</i>  <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.84 "Rregullorja e sekretarisë mësimore"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>U vlerësua nga GVJ se UAMD informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Kjo realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sekretaria mësimore pranë njësisë kryesore (fakultetit) dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë informojnë studentët në lidhje me procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme i bëhen të ditura studentëve dhe janë pjesë e dokumenteve rregullatore. Studenti, i cili dëshiron të transferojë studimet në UAMD, informohet për të gjitha procedurat, kriteret që ndiqen në rastin e transferimit të studimeve.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.21 "Rregullorja e DSHTM"</i>  <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.84 "Rregullorja e sekretarisë mësimore"</i>  <i>EVIDENCA Nr.95 "Faqja zyrtare në Fb e fakultetit"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se institucioni disponon dosjen personale (regjistrin) të çdo studenti që njihet me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Po ashtu rregullorja e institucionit parashikon elementet përbërës të vlerësimit dhe peshën specifike të tyre në raport me vlerësimin total. Vlerësimi është periodik dhe studentët gjithmonë informohen për rezultatet e vlerësimit (pas përfundimit të provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar) dhe detyrave të kursit referuar Rregullores së Departamentit DSHTM, Rregullores së UAMD, po ashtu dhe në Syllabusin e çdo lënde janë të reflektuara mënyra e vlerësimit të studentëve. Në fillim të vitit akademik, studentëve u vihet në dispozicion program/silabusi i çdo lënde të programit të studimit.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.21 "Rregullorja e departamentit të shkencave teknike mjekësore"</i>  <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.75 "Model Syllabusi, ku tregohet Mënyra e Vlerësimit të Studentëve"</i>  <i>EVIDENCA Nr.84 "Rregullore e Sekretarisë mësimore"</i>  <i>EVIDENCA Nr. 135 "Njoftime për provimin final"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të</p>	<p>GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, RVB, guidës në institucion, konstatoi se UAMD ka hartuar rregulloren e studimeve. <i>Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi përfundon</i></p>

<p>diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>me provim përfundimtar në fund të vitit të tretë, pasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet akademike dhe ekonomike. Në përputhje me afatet e përcaktuara në rregulloren e UAMD-së, departamenti përgjegjës në bashkërendim me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve informon studentët për modalitetet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar. Rregullorja e diplomimit, përcakton në mënyrë të detajuar procesin e diplomimit. Ky provim bëhet me quize dhe korrigjohet me anë të sistemit Clean Score. Dhe për këtë provim vendosen në dispozicion të studentëve temat përkatëse nga lëndët profesionale. Provimi përfundimtar bëhet përpara një komisioni të propozuar nga drejtuesi i departamentit dhe miratimin e dekanit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se 5 nga studentët me mesatare më të lartë se 8 (tetë) provimin përfundimtar (diplomimin) e japin me temë diplome. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit mbështetur në Rregullores së DSHTM, përmes orientimit nga udhëheqësit e tyre mbështetur në këtë Rregullore, nëpërmjet shpalljeve nga sekretaria, të takimeve orientuese me studentët për diplomim dhe përmes faqes së internetit dhe rrjeteve sociale.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.21 "Rregullorja e Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore"</i>  <i>EVIDENCA Nr.84 "Rregullore e Sekretarisë mësimore"</i>  <i>EVIDENCA Nr. 135 "Njoftime për provimin final"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni se UAMD organizon takime të hapura për informimin e maturantëve për programin e studimit "Bachelor në "Fizioterapi", po ashtu ka publikuar një spote promovues për programin e studimit dhe fletëpalosje promovuese. Gjatë vizitave në institucion GVJ konstatoi se UAMD ka strukturë (Drejtoria juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI) që merret me gjurmimin e studentëve dhe organizimin e ditëve të hapura për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programet e studimit. Takimet janë të organizuara (open day) dhe marrin pjesë pedagogët e njësisë bazë, anëtarë të personelit akademik, të cilët organizojnë takime periodike me nxënësit e shkollave të mesme . Përgjatë ditëve të regjistrimit, njësia kryesore vë në dispozicion të studentave të interesuar për të vazhduar studimet në programin e studimit Bachelor, grupe pedagogësh që japin informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve në UAMD dhe nga UAMD tek universitetet me programe të ngjashme brenda dhe jashtë shtetit</p> <p><i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.107 "Takime Informues me Maturantët dhe Udhëzuesit e Programit të Studimit"</i></p>





	<i>Vizita në institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga UAMD, konkludon se UAMD vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin e studimit Bachelor në Fizioterapi. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.3</b>																									
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>																									
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																								
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>GVJ në bazë të dokumentave referuese, planet mësimore, rregullore, sttutit, takimit me drejtues te institucionit, sekretarine mësimore, studentët konstaton se, UAMD vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. Informacionin studentët e marrin nëpërmjet takimeve me stafin akademik që i pret në institucion, në momentin që interesohen për programet e studimit, nëpërmjet kontakteve me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve, si dhe vënies në dispozicion të studentëve të rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit, programit të studimit. Bazuar në programin e studimit dhe rregulloret e UST që ndihmojnë dhe rregullojnë realizimin e programit mësimor, studentëve ju bëhet me dije që: Programi ka 180 kredite, të ndara në 60 kredite për cdo vit akademik dhe cdo vit akademik i ndarë në 2 semestre (sem I+II) me nga 15 javë mësimore çdo semestër.</p> <p>GVJ në takimin me komisionin e kurrikulave, drejtuesen e departamentit, konstaton se ky institucion e kishte të qartë ndarja e orëve mësimore për një kredit bazuar në udhëzimin të MAS në Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të Këshillit të Ministrave: Për organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit Të Lartë.</p> <p>Drejtorja e kurrikulave, bazuar dhe në Rregulloren e UAMD e ka të qartë se 1 kredit ekuivalentohet në 25 në orë mësimore, të ndara 12 orë në auditor dhe 13 orë individuale. Bazuar udhëzimeve të MAS, programi mësimor bën ekuivalentimin e 1 krediti në orë mësimore në auditor si më poshtë:</p> <table border="1"> <tr> <td>1 kredit lexion</td> <td>6-12 orë në auditor</td> <td>19-13 orë individuale</td> <td>25 orë</td> </tr> <tr> <td>1 kredit seminar</td> <td>6-8 orë në auditor</td> <td>19-17 orë individuale</td> <td>25 orë</td> </tr> <tr> <td>1 kredit ushtrime</td> <td>12-18 orë në auditor</td> <td>13-7 orë individuale</td> <td>25 orë</td> </tr> <tr> <td>1kredit laboratorë</td> <td>18-25 orë në auditor</td> <td>7-0 orë individuale</td> <td>25 orë</td> </tr> <tr> <td>1kredit projekt</td> <td>1-2 orë në auditor</td> <td>24-23 orë individuale</td> <td>25 orë</td> </tr> <tr> <td>Praktika</td> <td>20-25 orë në auditor</td> <td>5-0 orë individuale</td> <td>25 orë</td> </tr> </table>	1 kredit lexion	6-12 orë në auditor	19-13 orë individuale	25 orë	1 kredit seminar	6-8 orë në auditor	19-17 orë individuale	25 orë	1 kredit ushtrime	12-18 orë në auditor	13-7 orë individuale	25 orë	1kredit laboratorë	18-25 orë në auditor	7-0 orë individuale	25 orë	1kredit projekt	1-2 orë në auditor	24-23 orë individuale	25 orë	Praktika	20-25 orë në auditor	5-0 orë individuale	25 orë
1 kredit lexion	6-12 orë në auditor	19-13 orë individuale	25 orë																						
1 kredit seminar	6-8 orë në auditor	19-17 orë individuale	25 orë																						
1 kredit ushtrime	12-18 orë në auditor	13-7 orë individuale	25 orë																						
1kredit laboratorë	18-25 orë në auditor	7-0 orë individuale	25 orë																						
1kredit projekt	1-2 orë në auditor	24-23 orë individuale	25 orë																						
Praktika	20-25 orë në auditor	5-0 orë individuale	25 orë																						



	<p><i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.21 "Rregullorja e DSHTM"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.39 "Syllabuset e programit bachelor në Fizioterapi"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.40 "Dosja e programit të studimit bachelor në Fizioterapi"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Bazuar në RVB,takimin me drejtues të institucionit, takimi me stafin akademik, sekretarinë mësimore si dhe takimi me studentët mendon se: UAMD informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit <i>Bachelor në "Fizioterapi"</i>. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet ëeb-it.</p> <p>Çdo fillim viti akademik në faqen ëeb të UAMD, në hapësirën e fakultetit që ofron programin e studimit bëhet publike struktura e vitit akademik.</p> <p>Informacioni i nevojshëm publikohet në format letër, guida, rregullore dhe fletëpalosje, si dhe elektronikisht. Në formë të detajuar studentët kanë akses mbi ngarkesat, temat për çdo javë mësimore dhe literaturat e detyrueshme dhe ato të rekomanduara, detyrat apo diskutime të ndryshme, kreditet përkatëse, të cilat janë të shprehura qartë dhe në syllabuset e lëndëve të ndryshme. Studenti i akseson të gjitha të dhënat nëpërmjet llogarisë të dedikuar të sistemit të Pitagorës dhe faqes zyrtare on -line të UAMD. Studentët asistohen gjatë gjithë kohës nga stafi pedagogjik dhe sekretaria mësimore për çdo paqartësi. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacione nga sekretaria mësimore nga faqja zyrtare, nga pedagogët për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Informacionet gjenden edhe të afishuara në stendat e holleve të universitetit.</p> <p>Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion orari dhe ngarkesa mësimore semestrale. Po ashtu ora e parë studentët marrin info të detajuar nga pedagogët e lëndëve për syllabusin përkatës ku shprehen qartë: kreditet, kodi lëndor, raporti lexion/ seminar/ laborator/ praktik, temat, literaturë bazë dhe literaturën e rekomanduar, format e kontrollit dhe vlerësimit, detyrimet për lëndën (projekte, detyra kursi), niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.21 "Rregullorja e DSHTM"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.39 "Syllabuset e programit bachelor në Fizioterapi"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.40 "Dosja e programit të studimit bachelor në Fizioterapi"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin</p>	<p>GVJ, pas këqyrjes së dokumentacionit të grupit të vetëvlerësimit, dhe gjatë takimeve të GVJ në institucion, u konstatuan përpjekje të vazhdueshme të UAMD, për të studiuar tregun e punës dhe kërkesat e kriteret e tij. Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë orientimit të studentëve drejt tregut të punës, si në rang universiteti nëpërmjet Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni, ashtu si edhe Zyrës së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI janë dy zyra të institucionit të cilat u japin studentëve informacione mbi mundësinë e punësimit. Nëpërmjet organizimit të praktikave mësimore në institucionet partnere, studentëve me performancën më të mirë u ofrohet mundësi punësimi reale ose projektet bashkëpunuese me UAMD. Përmes aktiviteteve të</p>



drejt dhe në tregun e punës.	<p>vazhdueshme të sektorit të alumnit, studentët kanë mundësi të marrin informacione dhe orientim mbi tregun e punës.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i>  <i>EVIDENCA Nr.21 "Rregullorja e DSHTM"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.83 "Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare ëeb të UST dhe FSHR, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se studentëve, nëpërmjet ëeb-it, sekretarisë mësimore dhe stafit akademik, në mënyrë të vazhdueshme u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, përpara fillimit të çdo semestri akademik publikon Orarin Mësimor – lëndët/modulet, lektorët, auditorët, grafikun e orareve, kapacitet e auditorit, zhvillimin e praktikave dhe laboratorëve. Studentët marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në hapësirën respektive të programit të studimit në stendën informuese, e cila gjendet në një pozicion lehtësisht të aksesueshëm nga studentët, në hollin kryesor në hyrje të godinës. Informacioni i stendës përditësohet rregullisht me ndryshimet dhe njoftimet më të fundit. Faqja Ëeb dhe llogaritë në rrjetet sociale të universitetit dhe fakultetit janë një tjetër mjet për përditësimin e informacionit në kohë reale.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.94 "Faqja zyrtare e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.108 "Manual U-Albania RASH"</i>  <i>EVIDENCA Nr.94 "Faqja zyrtare e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.95 "Faqja e facebook e FSP"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Nga takimi me studentët GVJ konstanton se UAMD vë në dispozicion të studentëve informacionin, dokumentacionin dhe udhëzues të posaçëm për lëndët dhe veprimtarinë formuese. Studenti i akseson të dhënat nëpërmjet llogarisë personale në platformën Pitagora, që ata marrin në momentin e regjistrimit në UAMD nga Zyra e IT, nga ku nga ku kanë të drejtë të futen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit. Edhe në distancë, on-line përmes platformës studentët mund të shohin të dhënat në lidhje me programin e studimit, si edhe të komunikojnë me mesazhe në formë teksti me pedagogët e lëndëve dhe moduleve.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.94 "Faqja zyrtare e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.108 "Manual U-Albania RASH"</i>  <i>EVIDENCA Nr.94 "Faqja zyrtare e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.95 "Faqja e facebook e FSP"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ bazuar në RVB, guidën dhe takimet në institucion mendon se ky institucion vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për përmbajtjen e programit të studimit, objektivat, strukturën, organizimin, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Pas kqyrjes së dokumentacionit të grupit të vetëvlerësimit, dhe gjatë takimeve të GVJ në institucion, u konstatuan se Njësia e Këshillimit të Karrierës, ALUMNI dhe Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Studimeve Profesionale asiston në gjurmimin e studentëve dhe ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit. Institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me numrin e studentëve që vendosin të ndjekin programin Bachelor në Fizioterapi, dhe sigurisht edhe për studentët që do të diplomohen përfshirë këtu edhe nivelin edhe cilësinë e tyre në përfundim të studimeve. Nga përpunimi i të dhënave për 3 vitet e fundit, konstatohet se numri i studentëve në hyrje praktikisht është në rritje për shkak të kuotave të propozuara në varësi të infrastrukturës. Pranë sekretarisë ne u informuam për ecurinë vjetore të studentëve nga regjistrimi e deri në përfundim të studimeve, të dokumentuara edhe fizikisht (regjistra) dhe elektronikisht.</p> <p><i>Referenca Nr.41 "Të dhëna të plota të programit të studimit bachelor në 'Fizioterapi' për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>UAMD disponon statistika të sakta vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Fizioterapi si dhe për të gjitha programet e studimit që ofron UAMD. UAMD disponon statistika të sakta vjetore për numrin e transferimeve, largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimit me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Këto të dhëna ruhen edhe në sistem elektronik, Pitagora dhe menaxhohen nga sekretaria mësimore, nëpërmjet regjistrave të programit të studimit. Sekretaria mësimore na vendosi në dispozicion regjistrat dhe dosjen personale të çdo studenti, e cila krijohet që në momentin e regjistrimit të tij dhe përditësohet me të dhëna të tjera përgjatë "jetës universitare" të tij në UAMD. Kjo dosje përditësohet edhe me elementë të tjerë si dokumentacioni i ndjekjes së praktikës profesionale, apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p>GVJ gjatë inspektimit të dosjes dhe regjistrave të studentëve konstaton se ka një rritje të numrit të studentëve vit pas viti si re një rritje në nivelin e notës mesatare –(mesatarja e notave sipas VKM duke i rankuar në rend zbritës) në hyrje si më poshtë:</p>

Viti akademik	Rregjistrime	Program 2	Transferime
2020-2021	56 student		-
2021-2022	50 student		-
2022-2023	60 student	1 student	-

*EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"*  
*EVIDENCA Nr.83 "Regullore Sektorit të Komunikimit Alumnit & Karrierës"*  
*EVIDENCA Nr.41 'Të dhëna të plota të programit të studimit bachelor në 'Fizioterapi' për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje' Vizita në institucion*

**Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Gjatë vizitës në institucion u konstatua nga GVJ se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga Drejtoria Ekonomike. Gjithashtu, u konstatua se këto të dhëna janë të disponueshme në sekretarinë mësimore, sistemi Pitagora, të cilat janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave sipas nenit 69 i Rregullores së UAMD-  
*EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"*  
*EVIDENCA Nr.83 "Regullore Sektorit të Komunikimit Alumnit & Karrierës"*  
*EVIDENCA Nr.41 'Të dhëna të plota të programit të studimit bachelor në 'Fizioterapi' përregjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje' Vizita në institucion*

**Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.

GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës, RVB, takimin me drejtues, stafin akademik, sekretarine konstaton se, UAMD bën kontrole periodike, audit të brendshëm, harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Në fund të vitit kalendarik departamenti përgjegjës për programin e studimit analizon dhe harton një raport analitik mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimit profesional, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësime në të ardhmen. Një kopje e raportit të kësaj analize i përcillet dekanatit, që nga ana e vet i përpunon këto edhe mbi bazën e raporteve të ardhura nga departamentet e tjera, për të hartuar një raport analitik në nivel njësie kryesore. Ky raport shërben si bazë për hartimin e objektivave për vitin pasues. UAMD/FSP/DSHTM disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.  
*EVIDENCA Nr.41 'Të dhëna të plota të programit të*



	<i>studimit bachelor në 'Fizioterapi' për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje' Vizita në institucion</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit dhe drejtuesin e departamentit si dhe në të dhënat e RVB, konstaton se njësia bazë harton raporte periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, ecurinë në vitet akademike si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve për vitet e ardhshme akademik. Drejtuesit e njësisë bazë këtë informacion vjetor, periodik të diskutuar më parë në departament e përcjell në dekanat, për hartimin e objektivave, kuotave për vitin pasues.</p> <p>Zyra e Këshillimit dhe Karrierës së bashku me Departamentin e Shkencave Teknike Mjeksore ndjekin ecurinë e studentëve e diplomuar dhe mundësojnë përpilimin e tabelave me të dhëna mbi cilësinë e punësimit.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.41 "Të dhëna të plota të programit të studimit bachelor në "Fizioterapi" për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.110 "Aktivitetet e Zyrës së Karrierës"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD-së"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ bazuar në RVB, guidën dhe takimet në institucion mendon se ky institucion realizon një audit të brendshëm periodik, mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Bazuar në rregulloren e UAMD, Statutin e UAMD, RVB, takimin me studentët të vëna në dispozicion, GVJ mendon se ky institucion me anë të rregulloreve përkatëse menaxhon përfshirjen e studentëve në vendimmarrjen e universitetit, përmes përfaqësimit të tyre në organet drejtuese të institucionit dhe në strukturat mësimore-kërkimore. Më kryesoret përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Këshilli i Studentëve në rang njësie kryesore dhe univeristeti</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Senati Akademi</li> <li>▪ Këshilli Etikës</li> <li>▪ NJSBC</li> </ul> <p><i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD-së"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.109 "Komisionet me përbërje të studentëve"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës GVJ konstatoi se UAMD garanton përfshirjen e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. Përpara përfundimit të semestrit studentët bëjnë vlerësimin të programit të studimit në bazë lënde, përmes pyetësorit që plotësojnë, i cili garanton anonimin e studentëve. Instrumenta të tjerë janë dhe "Focus Group"-et dhe intervistatet gjysmë të strukturuar, me grupe studentësh të programeve përkatëse, për të trajtuar shqetësimet dhe pritshmëritë e tyre. Gjithashtu, Departamenti përgjegjës për programin e studimit merr masa që një anëtar student të bëjë pjesë në grupin e punës për rishikimin e programeve/silabeve të lëndëve. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm. Një student i programit Bachelor është pjesë e GVB-së të ngritur në kuadër të hartimit të këtij raporti.</p> <p>Përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje në UAMD realizohet bazuar në Statutin dhe Rregulloren e IAL-së. Në to shprehet qartë angazhimi i studentëve në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësim të procesit akademik.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD-së"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.109 "Komisionet me përbërje të studentëve"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, konsultimi me dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe takimet me studentët konstatoam se UAMD garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit dhe reflekton sugjerimet e tyre në to. Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes një pyetësorit anonym me studentët, fokus grupeve. Pyetësori organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit.</p> <p>Ndër rubrikat e pyetësorit është që të vlerësohet edhe silabusi i lëndës. Takimet këshilluese të studentëve me përfaqësues të Zyrës</p>

	<p>së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve, në disa raste edhe në praninë e koordinatorit të programit. Gjetjet e tyre, bëhen pjesë e diskutimeve, raporteve analitike semestrale e vjetore, dhe mund të shoqërohen me ndryshime në programin e studimit</p> <p><i>EVIDENCA Nr. 17 “Rregullore e e programit të studimit bachelor në “Fizioterapi”</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 07 “Urdhër i Dekanit të Fakultetit të Studimeve Profesionale nr. 31, nr. 396/2 prot., datë 21.12.2021 për ngritjen e GVB për departamentet e FSP”</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.109 “Komisionet me përbërje të studentëve”</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 111 “Pyetësor për marrjen e mendimeve të studentëve lidhur me përmirësimin të programit të studimit”</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin si dhe takimet me studentët GVJ konstatoi se studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme dhe pasqyrohet në programin/silabusin e secilës lëndë. Tezat e sekretuara, shpjegimet e pedagogut për vlerësimin, rishikimi i tezës dhe çelësit të përgjigjeve, dhe mundësia për rivlerësim nga një komision i posaçëm, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashtrojnë kërkesat e tyre duke ndjekur procedurat e parashikuara në rregulloren e institucionit. Gjatë takimit me drejtuesit e institucionit dhe studentët nuk kishte një rast të dokumentuar ankimimi.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.11 “Statuti i UAMD-së”</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.12 “Rregullorja e UAMD”</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.16 “Rregullorja e FSP”</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 111 “Pyetsor për marrjen e mendimeve të studentëve lidhur me përmirësimin të programit të studimit”</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.112 “Kërkesa të studentëve për rivlerësim rezultati”</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.113 “Pyetësor i studentëve”</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion, takimin me stafin akademik dhe studentët mendon se ky institucion angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimin të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe ky anagazhim studentor rregullohet sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve, Statusit të UST. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<b>Standardi V.6</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion, takimin me stafin akademik dhe studentët konstaton se ky institucioni siguron informim, këshillim e orientim për studentët e të gjithë programeve dhe të gjithë cikleve të studimit, si në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore. Informimi i studentëve nga stafi, sekretaria bëhet që në ditët e informimit për të zgjedhur këtë universitet, po ashtu të drejtën e informimit studentët e marrin fizikisht në institucion te sekretaria, drejtuesit e institucionit, me anë të posterave të afishuara në vende të dukshme të institucionit, apo në distancë nëpërmjet informimit on line me anë të sitemit të Pitagorës. GVJ mendon se këto të drejta të informimit studentor janë të shprehura dhe në rregullore të ndryshme dhe Statutin e UAMD-së.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i>  <i>EVIDENCA Nr.83 "Rregullore Sektorit të Komunikimit Alumnit &amp; Karrierës"</i>  <i>EVIDENCA Nr.114 "Alumni UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Gjatë vizitës në institucion, takimet e realizuara me stafin, drejtuesit, sekretarinë, studentët GVJ konstatoi se UAMD ka një system të mirë organizuar për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor nga dita e regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Studentëve u ofrohet shërbim i vazhdueshëm i këshillimit të karrierës me ndihmën e Drejtorisë së Koordinimit, Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, ALUMNI, kujdesin e zyrës së njësisë së monitorimit të Kurrikulës, mbështetur në Rregulloren e NJSBC.</p> <p>Koordinimi i aktivitetit të zyrave të mësipërme në rang Universiteti është tregues të një sistemi të përshtatshëm të asistencës së vazhdueshme ndaj studentëve.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.83 "Rregullore Sektorit të Komunikimit Alumnit &amp; Karrierës"</i>  <i>EVIDENCA Nr.114 "Alumni UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i>  <i>EVIDENCA Nr.116 "Pyetësor për mësimin online"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor,	<p>GVJ siç e përmendëm dhe në kriterin 2, konstaton se UAMD u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Studentëve u ofrohet këshillimi i karrierës, me anë të disa zyrave dhe drejtorive si, zyra e këshillimit të karrierës, drejtoria e koordinimit, marrëdhënieve me jashtë, ALUMNI.</p>



<p>zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Këto zyra janë në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me, aktivitete të ndryshme studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, projekte të ndryshme, mundësi punësimi duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Gjithashtu UAMD ka krijuar kontakte me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale/intershipeve të studentëve, por edhe të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.83 "Regullore Sektorit të Komunikimit Alumnit &amp; Karrierës"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.114 "Alumni UAMD"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, takimet e realizuara me stafin, drejtuesit, sekretarinë, studentët GVJ konstatoi se UAMD ka një system të mirë organizuar për informimin, këshillimin e studentëve dhe ka disa zyra dhe drejtor të cilat ndjekin në mënyrë periodike studentët jo vetëm gjatë viteve akademike, por edhe pas punësimit të tyre. Drejtoritë dhe zyrat përkatëse si, Drejtoria e Koordinimit, Marrëdhënive me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, ALUMNI mban kontakte për pjesëmarrje në trajnime pasuniversitare brenda apo jashtë vendit si dhe mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UAMD.</p> <p>Zyra bën gjurmimin e ndjekjen e të diplomuarve dhe krijon e freskon bazën e saj të të dhënave, në vijim të përfutimit të të dhënave prej plotësimit në mënyrë elektronike të "Formularit Alumni", nga të diplomuarit. Baza e të dhënave u vihet në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.83 "Regullore Sektorit të Komunikimit Alumnit &amp; Karrierës"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.114 "Alumni UAMD"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.115 "Model Pyetësori për Studentet e Diplomuar Alumni"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ mendon si konkluzion se UAMD ka procedura , zyra, drejtor, e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. UAMD falë këtyre zyrave bën të mundur ndjekjen e punësimin e tyre edhe pas mbarimit të studimeve. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, takimin me drejtuesit e institucionit, stafin, studentët, NJSBC, referencat e vëna në dispozicion, mendon se, UAMD, ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet NJSBC-së, siguron zbatimin një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC, e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, dhe në funksion plotësisht në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit.</p> <p>NJSBC vlerëson në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike funksionalitetin, efikasitetin dhe produktivitetin e stafit të IAL në lidhje me veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore. NJSBC ka të drejtë të ketë akses dhe të kontrollojë në të gjitha materialet dhe të dhënat e institucionit në bazë të plani strategjik të zhvillimit të UAMD. Mësimdhënia bëhet gjithmonë në përmirësim bazuar dhe në infrastrukturën, Sistemin Pitagora që aplikohet , në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi të statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore ,duke vënë në dispozicion metoda kreative jo vetëm në auditor por dhe në distancë për tematika të ndryshme mësimore, laboratore, detyra kursi etj.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.117 "Zhvillimi strategjik I UAMD 2020-2025"</i>  <i>EVIDENCA Nr.20 "Raport i kordinatorit për metodat e mësimdhënies për programin studimit"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Gjatë guidës në institucion GVJ u informua se në mënyrë të vazhdueshme, 2 herë në vit, në fund të cdo semestri realizohet një pyetësor anonim me studentët, me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë e stafit, ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila ka përfaqësues nga të gjitha njësitë bazë dhe 1 përfaqësues nga studentët, përbërja e NJSBC përcaktohet edhe në Statutin e UAMD.</p> <p>Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin dhe produktivitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore shkencore të UAMD -së, duke përmbledhur të gjitha problematikat që mund të dalin nga</p>

	<p>ky vlerësim periodic. NJSBC shpesh herë konsultohet edhe me ekspertë të jashtëm, për një mbarëvajtje në të gjitha hallkat e procesit mësimor. Në përbërjen e NJSBC sipas Statutit të UAMD janë 7 anëtarë (1 Kryetari, 4 njësitë bazë dhe 1 përfaqësues nga studentët dhe 1 përfaqësues expert i jashtëm). Disa nga mekanizmat që përdoren për monitorimin e këtyre aftësive janë: formularët e vetëvlerësimit dhe CV e përditësuara të stafit akademik; formularët e vlerësimit të cilët plotësohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe më pas nga Dekani.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD-së"</i>  <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i>  <i>EVIDENCA Nr.118 "Model tip Formularët e vetëvlerësimit të DSHTM"</i> <i>EVIDENCA Nr.13 "Cv e stafit akademik të DSHTM"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ në takimin e realizuar me studentët konfirmoi se UAMD garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. Studentët referojnë se gjatë vititeve akademike, ata në formë elektronike plotësojnë një pyetësor anonym. Pyetësori ka disa rubrika të cilat lidhen kryesisht me, programin, lëndët syllabuset, mësimdhënia, performanca e stafit akademik, ndihmës akademik, infrastrukturën etj. Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik bëhet jo vetëm me anë të pyetësorëve tek studentët për mbledhjen e të dhënave lidhur me aspekte të ndryshme të veprimtarisë mësimore e asaj administrative, në përputhje kjo me pikat 3 &amp; 4 të nenit 103 të Ligjit 80/2015; por dhe takime formale dhe informale me studentët, kontaktimit akademik dhe administrativ nëpërmjet e-maili për marrjen e informacioneve të domosdoshme. Pas mbledhjes së informacioneve përkatëse bëhet raportime tek drejtuesit;</p> <p>Për të ardhur në ndihmë GVJ në ndihmë të akreditimit të jashtëm, në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015 NJSBC e UAMD ka gjeneruar informacion sasior dhe cilësor.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se, të gjitha të dhenat e grumbulluara dhe të shfrytëzuara për ndryshimet në funksion të rritjes së cilësisë ruhen dhe i paraqiten Rektorit dhe Senatit Akademik nga Njësia e Vlerësimit të brendshëm në një raport vjetor mbi veprimtarinë e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, mbi shërbimet e kryera nga UAMD.</p> <p>Po ashtu, kjo njësi raporton në lidhje me rezultatet e shprehura nga studentët, si edhe mbi nivelin e funksionalitetit dhe efikasitetit të arritur nga njësitë specifike bëhet analiza e cdo problematike</p>

	<p>(departament, sekretari, bibliotekë) etj. Në raportin vjetor, i paraqitet Rektorit dhe Senatit, me rekomandimet për vitin akademik pasardhës nëpërmjet rekomandimeve dhe analizave të synuara (të tipit SWOT).</p> <p><i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i>  <i>EVIDENCA Nr.119 "Komunikimet me email për transparencë të pyetësorëve të studentëve me lektorët"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit, përgjegjës in e departamentit, NJSBC, u informua se informacioni i mbledhur nga vlerësimi i bërë pasi i bëhet një përpunim statistikor i paraqitet Rektorit dhe Senatit, me rekomandimet për vitin akademik pasardhës nëpërmjet rekomandimeve dhe analizave të synuara (të tipit SWOT), duke nxjerr në pah mangësitë (nuk ka patur ndonje praktikë të tillë). Punonjësit promovohen me anë të suportit nga institucioni përsa i përket motivimit për kërkimin shkencor në mënyrë që të realizojnë detyrat në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe rregulloret e brendshme të UAMD, si dhe rregulloren e programit të studimit duke garantuar rigorozitet në evidentimin e problemeve dhe efikasitet në zgjidhjen e tyre.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD-së"</i>  <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i>  <i>EVIDENCA Nr. 111 "Pyetësor për marrjen e mendimeve të studentëve lidhur me përmirësimin të programit të studimit"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se UAMD ka një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të cilat ndihmojnë institucionin për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe performancën e stafit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

<p><b>Standardi VI.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Gjatë guidës në institucion GVJ u informua se në mënyrë të vazhdueshme, realizohet një pyetësor anonim me studentët, me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë e stafit, ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), përbërja e NJSBC përcaktohet edhe në Statutin e UAMD. Në UAMD synimi kryesor i strukturës dhe procedurave</p>



	<p>për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është arritja e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit, duke përdorur mekanizma të sigurimit të cilësisë në çdo aspekt. NJSBC ka politika dhe funksionon në bazë të legjislacionit në fuqi, pikat 3 &amp; 4 të nenit 103 të Ligjit 80/2015 të IALP si dhe rregulloreve të brendshme të UAMD dhe Statutit të UAMD dhe manualit të ASCAL.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.04 "Ligjit të Ri të Arsimit të Lartë, 2015"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullore NJSBC"</i>  <i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.120 "Manual ASCAL"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UAMD përmbush kriteret ligjore dhe ka të ngritur NJSBC. UAMD ka një NJSBC, e cila përbëhet nga 7 anëtarë, sipas Statutit të UAMD ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm.</p> <p>Kjo njësi kontrollon dhe i paraqet Rektorit një raport vjetor mbi aktivitetin mësimor, kërkimor dhe mbi shërbimet e ofruara nga IAL-ja. Njëkohësisht është përgjegjëse për mbledhjen, menaxhimin, ruajtjen dhe komunikimin e mendimeve të studentëve për mësimdhënien që është dhënë.</p> <p>Për realizimin e funksioneve të saj NJSBC bazohet në rregulloren e funksioneve të saj, statutin e UAMD, Ligjin e Ri të Arsimit të Lartë, 2015 dhe ka të drejtën e aksesit në të gjitha dokumentet, dhe informacionet e tjera të Universitetit dhe në të njëjtën kohë të ruajë konfidencialitetin e dokumenteve të mbledhura.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.04 "Ligjit të Ri të Arsimit të Lartë, 2015"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullore NJSBC"</i>  <i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion dokumentat e vëna në dispozicion se, ky institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. NJSBC ka rolin kryesor në monitorimin e cilësisë. Ky monitorim realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p> <p>Ne konstatojmë se institucioni përdor në nivel operacional:</p> <p>a) <i>pyetësorët tek studentët</i> për mbledhjen e të dhënave lidhur me aspekte të ndryshme të veprimtarisë mësimore e asaj administrative, në përputhje kjo me pikat 3 &amp; 4 të nenit 103 të Ligjit 80/2015;</p> <p>b) Takime formale dhe informale me studentët</p> <p>c) kontaktim akademik dhe administrativ nëpërmjet e-maili për marrjen e informacioneve të domosdoshme</p> <p>Në aspektin taktik, institucioni përdor:</p>

	<p>a) <i>raportime tek drejtuesit;</i></p> <p>Sa i përket aspektit strategjik, NJSBC ka gjeneruar informacione sasiore dhe cilësore, për të ardhur në ndihmë edhe GVJ në ndihmë të akreditimit të jashtëm, në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015 në këtë aspekt.</p> <p>Të dhënat e këtij monitorimi diskutohen në njësitë bazë, dekanati, rektorat, senat dhe shohin mundësitë për përmirësimin e problematikave.</p> <p>UAMD përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. UAMD ju nënshtrua në vitin 2016 procesit të Akreditimit Institucional dhe ka marrë Akreditim për 5 vite akademike, si dhe riakreditimit me Vendim Nr. 18 Datë 24.03.2022 dhe u riakreditua për 4 vite deri në datën 23.03.2026.</p> <p>Struktura e përbërëse e NJSBC përcaktohet në Rregulloren e NJSBC. Në zbatim të kësaj rregulloreje, Institucioni ka ngritur komisionin e Vlerësimit të Brëndshëm në rang fakulteti dhe në rang departamenti dhe për çdo program studimi janë ngritur grupet për vetëvlerësimin e brendshëm.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.103 "Çertifikata e akreditimit të parë Institucional Nr. 10 datë 07.04.2017"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.07 "Vendim për ngritjen e komisionit për vlerësimin e brendshëm të cilësisë FSP"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.07 "Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e vetëvlerësimit të brendshëm"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ mendon se UAMD përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, për pasqyrimin performancës së stafit. Siç jemi shprehur dhe më lart në UAMD përgatitet në mënyrë periodike analizat vjetore në bazë institucionale, në çdo njësi bazë. Aty përshkruhet pjesa më e madhe e informacionit mbi ngarkesën mësimore, aktivitetin shkencor, cilësinë e lexioneve të miratuara më parë në departament, të dhënat e dala nga monitorimi i vazhdueshëm i stafit. Ky raport më pas u dërgohet dhe vihet në dispozicion edhe stafit akademik dhe administratës.</p> <p>Fakulteti i Studimeve Profesionale harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin vazhdueshëm të cilësisë. Në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimeve që ofron UAMD dhe strukturat e saj si NJSBC; NJSBC dhe Koordinatorët e programeve përgatisin raporte periodike (3-mujorë, 6-mujorë dhe vjetorë) të vetëvlerësimit të cilët i propozohen Senatit Akademik për miratim. NJSBC monitoron dhe vlerëson procedurat dhe standardet e fakulteteve dhe njësitë të tjera</p>

	<p>të institucionit, Strategjia, politika dhe procedurat janë të publikuara, referuar statutit të UAMD-së.  <i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD-së"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i>  <i>EVIDENCA Nr.07 "Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e vetëvlerësimit të brendshëm"</i>  <i>EVIDENCA Nr.20 "Raport i koordinatorit mbi metodat bashkëkohore për programin e studimit bachelor në Fizioterapi"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ pas shqyrtimit të RVB, dokumentave të vëna në dispozicion, guidës në UAMD mendon se UAMD, zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe rregulloret e brendshme të UAMD. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga takimi me përfaqësues të institucionit konkludon se në mënyrë periodike institucioni është kujdesur për vlerësimin e brendshëm si në nivel fakulteti ashtu dhe departamenti duke hartuar raport përkatëse të veprimitarisë.</p> <p>Ky raport shërben si dokument bazë për vetëvlerësimin e programeve të studimit. Gjithashtu raportet e vlerësimit të brendshëm ishin pjesë e dokumentacionit të shfrytëzuar gjatë procesit të akreditimit institucional. Në këtë raporte evidentohen arritjet dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. Gvj konstaon se I gjithë procesi I mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit bazohet në rregullore të brendshme të institucionit si dhe bazohet në ligjshmërinë në fuqi.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD-së"</i>  <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i>  <i>EVIDENCA Nr. 102 "Rregullore menaxhimit të kërkimit Shkencor"</i>  <i>EVIDENCA Nr.53 "Dosja e vetëvlerësimit të lektorëve"</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p><i>Vizita në institucion</i></p> <p>Sipas takimit me përfaqësues të insitucionit dhe dokumentat e vëna në dispozicion GVJ mendon se NJSBC përgatit dhe shpërndan në formën e një analize vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e programeve të studimit (përmes anketimeve me pyetësorë dhe fokus grupe), i cili u vihet në dispozicion Rektorit. Strukturat drejtuese i përfshijnë elementë të këtyre raporteve si pjesë e diskutimit në nivel departamenti, në nivel fakulteti dhe në nivel rektorati dhe në senat. Raportet e vlerësimit të NJSBC përfshijnë rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> <p>Raportet e vlerësimit të NJSBC, për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, realizon pyetësorë anonim, ku studentët japin mendimin e tyre në lidhje me zhvillimin e komponentëve të modulit, përgatitjen e pedagogut, sjelljen e tij, etj. Studentët shprehin mendimin e tyre në sondazhe, intervista të dryshme të realizuara nga Zyra e Karrierës dhe Alumni, apo nga punë dhënës të ndryshëm. Instrumentet kryesor që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe zhvillimi i pyetësorëve online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve, etj.</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UAMD në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <p>Teste të standardizuara;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dëgjime në auditor;</li> <li>- Vlerësimi me pikë;</li> <li>- Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module;</li> <li>- praktikë;</li> <li>- Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët;</li> <li>- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës/laboratoreve.</li> <li>- Kontrolli periodik i të gjitha proceseve akademike përfshirë mësimdhënien dhe mësimnxënies</li> <li>- Ecuria e kontrollit të zbatimit të kurrikulës,</li> <li>- Kontroll periodik për realizimin e programeve, syllabuseve sipas modelit të miratuar</li> </ul> <p>Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe vizitat nga eprori (Përgjegjës departamenti /Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me plotësimin e një raporti vlerësimi. Në kushtet e përdorimit të platformave on line si Sistemi i Pitagorës UAMD dokumentohet monitorimi i zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, praktikave etj e cila është mundësuar nga Zyra e IT në UAMD nëpërmjet raporteve të vazhdueshme mbi prezencën në mësim, mbi kohëzgjatjen e orëve</p>



	<p>mësimore, etj. Lidhur me cilësinë dhe metodologjitë e mësimdhënies, orët mësimore janë monitoruar nga Përgjegjësi i Departamentit. GVJ konstaton se këto metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës etj janë pothuajse dy herë në vit me pyetësor anonym dhe herë pas here nga drejtuesit e departamentit në auditore, laboratore. Për cdo konstatim ka një raport mbi këto vlerësime. Nga mbledhja e të dhënave nuk ka ndonjë rast konkret për tu tërhequr vëmendjen.</p> <p>NjBSC-ja bashkëpunon me strukturën përgjegjëse të institucionit për të dhënat statistikore që do të parashikonte një analizë sistematike të këtyre treguesve. Gjithashtu lektorët dorëzojnë në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme CV-të dhe dosjet e tyre të vetëvlerësimit të përditësuara, të cilat i disponojnë të gjithë shefat e departamenteve dhe tek burimet njërezore. Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve vlerësohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe nga drejtuesi i njësisë kryesore. Në bazë të formularëve të raporteve çdo lektor vlerësohet me pikë për çdo fushë të kërkimit të tij shkencor gjatë një viti akademik, vlerësimi bëhet në bazë të performancës i cili kalkulohet nga koordinatori i kërkimit shkencor i cili është përzgjedhur me vendim departamenti</p> <p><i>EVIDENCA Nr.14 "CV e stafit akademik për programin e studimit bachelor në "Fizioterapi"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.53 "Dosja e vetëvlerësimit të stafit akademik DSHTM"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 123 'Formular i raportimit të performancës së kërkimit shkencor'</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.119 "Transparenca e Rezultateve të Anketimeve të Studentëve"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentat e vëna në dispozicion dhe takimi me përfaqësues të UAMD konstaton se, institucioni ka zhvilluar pyetësor anketues me studentë me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të studentëve në programe specifike.</p> <p>Metodat e tërthorta përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve.</li> <li>• Sondazhe: të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit.</li> <li>• Pyetje konceptuale.</li> <li>• Intervista. Vlerësimi me pikë me anë testimeve dhe të sistemit CleanScore;</li> <li>• Teste të ndërmjetëm dhe përfundimtar; provime për module, praktikë 1, 2, 3</li> <li>• Vlerësimi i të detyrave të kursit, punëve individuale dhe punëve në grup/detyrave/projekteve që kryhen nga studentët;</li> </ul>

	<p>Për stafin akademik, në mënyrë periodike dhe sistematike janë zhvilluar kontrole të ndryshme nga eprori përgjegjësi njësisë bazë, dekani, zv. dekani, gjatë kryerjes së orëve mësimore në auditor, orëve praktike në laborator dhe orëve të lëndës praktikë që zhvillohen jashtë institucionit me institucionet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesëve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si dhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre.</p> <p>NjsBC në çdo rast dokumenton dhe i bën të njohur Senatit Akademik informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit. Një prej instrumenteve për analizimin e arritjeve të misionit institucional është përcaktimi i një grupi treguesish kyç të performancës (TKP),</p> <p>TKP-ja përfshijnë elementë si :</p> <p>Ruajtja e nivelit të regjistrimeve, nivelet e kalueshmërisë, nivelet e diplomimit, diversiteti i profileve studentore, ndërkombëtarizimi etj. Këto të dhëna mblidhen në nivel fakulteti dhe i dërgohen NjBSC-së, çdo fillim viti akademik. NJSBC ka për detyrë të japë mendim në formën e sugjerimeve dhe masave korrigjuese, i propozohen Senatit Akademik për miratim. Dekanët e fakulteteve, në konsultim me stafin akademik të çdo departamenti, përcaktojnë prioritetet e fakulteteve për t'i renditur me prioritetet e universitetit.</p> <p>Instrument tjetër që ofron të dhëna treguesish të performancës është dhe rishikimi vjetor i veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore përgatitur nga NjBSC-ja, numrin e publikimeve dhe kërkimeve shkencore, mënyrën sesi funksionon sistemi i sigurimit të cilësisë, si dhe çdo ankesë për funksionimin e sistemit.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.53 "Dosja e vetëvlerësimit të stafit akademik DSHTM"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr. 123 'Formular i raportimit të performacës së kërkimit shkencor'</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i></p> <p><i>EVIDENCA Nr.119 "Transparenca e Rezultateve te Anketimeve te Studenteve"</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ mendon se ky institucion e plotëson këtë standart pasi vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet dhe disponon raporte periodike të vlerësimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB si dhe dokumentat e vëna në dispozicion si psh manuali i Cilësisë së UAMD, përcaktohet roli i strukturave akademike dhe administrative si dhe roli i Senatit Akademik lidhur me sigurimin e Cilësisë. Një nga këto politika, është ngritja pranë departamenteve e organeve këshilluese të Bordeve të Tregut të Punës. Po ashtu, përfshirja dhe angazhimi në NJSBC i një eksperti të jashtëm, i cili i përgjigjet nevojës së Universitetit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm.</p> <p>UAMD ka arritur të sigurojë përfshirjen si partner në projekte europiane, mobilitetin e stafit, studentëve që kanë në fokus sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë: Aspektet pozitive të përfshirjes në këto projekte lidhen me shkëmbimin e përvojave, njohja me qasje të reja dhe të ndryshme, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimin e akteve rregullatore, metodologjisë dhe instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Lidhur me sigurimin e cilësisë, ka patur gjithashtu shkëmbime të stafit akademik dhe administrativ – me focus në mësimdhënie dhe trajnim – në kuadër të projektit Erasmus+.</p> <p>Në këtë kuadër mund të përmendim nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis UAMD dhe Universiteteve homologe në rajon.</p> <p>UAMD i jep prioritet angazhimit të studentëve si aktor të brendshëm të institucionit, në cdo nivel të vendimarrjes. Përfaqësues të studentëve gjejmë në çdo organ kolegjal, duke filluar nga Senati Akademik e deri tek GVB që ka hartuar këtë Raport të Vlerësimit të Brendshëm, në Bordin e Administrimit, NjBSC të fakultetit dhe në formë këshillimore, përfaqësi e studentëve marrin pjesë edhe në mbledhjet e Dekanatit dhe Departamentit kur trajtohen çështje të lidhura me ta.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD-së"</i>  <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i>  <i>EVIDENCA Nr.07 "Komisionet me përbërje të studentëve"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në takimin e realizuar me stafin dhe Studentët, GVJ u informua se studentët përfshihen në vlerësim përmes anketimit, dhe forumeve të debatit. Përfshihen edhe në vendimmarrje përmes përfaqësisë së tyre në Senatin Akademik, si pjesë e Qeverisjes së UAMD, përfaqësisë në Komisionin e Etikës, Këshillit studentor, si dhe përfaqësisë në NJSBC. Gjithashtu, përgjegjësitë, detyrat e NJSBC janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit.</p> <p>UAMD/FSP/DSHTM përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për çdo njësi, individ, studentët dhe palë të tjera të angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në takime dhe komisione të ndryshme nëpërmjet ngritjes së grupit të punës së vlerësimit të brendshëm.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullore e NjBSC"</i>  <i>EVIDENCA Nr.07 " Urdhër Dekani, Fakultetit të Studimeve Profesionale nr 31, nr. 369\2Prot., Datë 21.12 2021"</i>  <i>EVIDENCA Nr.07 "Komisionet me përbërje të studentëve"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, mund të pohojmë një gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit Administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme të Departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësime apo ndryshime në programet e studimit. Në përbërjen e NJSBC-së UAMD aktualisht ka përfaqësues nga njësitë bazë (FSP) të institucionit , i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e sigurimit të cilësisë, për përgatitjen e raporteve dhe bashkëpunimin me NJSBC-në e UAMD.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD-së"</i>  <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>UAMD është i angazhuar në respektimin e integritetit akademik dhe në shmangien e çdo diskriminimi apo pabarazie të të gjithë palëve të përfshira në këtë proces vlerësimi. Përzgjedhje e aktorëve të brendshëm në proceset periodike të vlerësimit bëhet nga nga personeli akademik ku merren parasysh disa kritere të përfshirjes si, integriteti, aftësitë dhe kompetencat profesionale; mundësitë për përtimin dhe grumbullimin e informacionit dhe përpunimin e tij me qëllim realizimin e vlerësimeve të ndryshme. Procesi i vlerësimit zhvillohet duke respektuar Kodin e Etikës dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik dhe studentëve. Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, UAMD ka krijuar grupet e</p>





	punës që sigurojnë këtë të fundit në për mbarëvajtjen në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë shkencore dhe vëmendjes ndaj studentëve. <i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i> <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i> <i>Vizita në institucion</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Përveç vlerësimit të brendshëm, element tjetër i sigurimit të cilësisë është dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit, ku pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësim të përmbushjes së standardeve të cilësisë. Po ashtu UAMD është e hapur dhe shumë aktive për realizimin sa më cilësor të proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe gjithashtu edhe për angazhimin e ekspertëve të jashtëm të cilët mund të japin ekspertizën dhe mendimet e tyre në bashkëpunim me strukturën e NJSBC-së, por edhe me takime me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë janë element që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ekspertët e jashtëm janë bërë edhe bashkëpunëtorë që kanë lidhje me programin e studimit bachelor në "Fizioterapi" që japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. <i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD-së"</i> <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i> <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i> <i>Vizita në institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ pas shqyrtimit të RVB, dokumentave të ndryshme të vëna në dispozicion si guidës në institucion mendon se UAMD përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon institucionin në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.5</b> <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Çdo informacion në lidhje me politikat dhe praktikatat që lidhen me sigurimin e Cilësisë në UAMD është i aksesueshëm nga i gjithë stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët. Këto të dhëna janë transparente dhe publike për të gjithë palët e interesuara.  Veprimtarinë e saj NJSBC-ja në bashkëpunim edhe me Zyrë e Këshillimit dhe Karrierës e zhvillon të organizuar sipas një planifikimi periodik, Planit të veprimit të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksionet e hapura nga ekspertë të fushës së rehabilitimit</li> <li>• Ëorkshop me studentët e UAMD</li> <li>• Konferenca vjetore institucionale</li> <li>• Mbajtja e takimeve periodike orientuese dhe me diskutime të hapura për studentët (Orientim mbi praktikën profesionale/metodat e fizioterapisë).</li> </ul> <p><i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i>  <i>EVIDENCA Nr.125 "Raporti Vetëvlerësimit në nivel Institucional UAMD"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konkludon në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni se UAMD vlerëson dhe përpiqet për efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive për monitorimin e cilësisë me qëllim përmirësimin e programit të studimit. Konkretisht çdo vit realizohet analiza e punës mësimore e cila shoqërohet nëpërmjet "kontrollit të kryqëzuar" (cross-check) që implementohet nga struktura dhe aktorë të brendshëm në UAMD, duke filluar nga njësitë bazë nëpërmjet drejtuesit të departamentit, përgjegjësit të grup-lëndëve, koordinatorit të programit, te strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i>  <i>EVIDENCA Nr.125 "Raporti Vetëvlerësimit në nivel Institucional UAMD"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me drejtues të UAMD dhe stafin akademik, dokumentave të vëna në dispozicion, konstatoi se institucioni organizon një plan të punës në përputhje me rregulloren e programi të studimit Bachelor në "Fizioterapi", rregullores së institucionit, planit vjetor të FSP-së, dhe planit të veprimit të NJSBC për arritjen e synimeve. Gjithashtu UAMD organizon mbledhjet e Departamentit si dhe mbledhjet e Asamblesë Akademike, të cilat përbëjnë dhe mënyrat më të shpeshta të informimit mbi arritjet dhe problematikave; në këto mbledhje bëhet identifikimi i nevojave për ndërhyrje apo për përmirësim të programit të studimit</p> <p><i>EVIDENCA Nr.11 "Statuti i UAMD-së"</i>  <i>EVIDENCA Nr.12 "Rregullorja e UAMD"</i>  <i>EVIDENCA Nr.16 "Rregullorja e FSP"</i>  <i>EVIDENCA Nr.36 "Rregullorja e NJSBC"</i>  <i>EVIDENCA Nr.125 "Raporti Vetëvlerësimit në nivel Institucional UAMD"</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ gjatë takimit me drejtues të UAMD konstatoi se UAMD organizon Politika të ndryshme të vlerësimit , dhe veprimtari për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, të cilat</p>

	<i>janë publike dhe transparente për të gjitha grupet e interesit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Fizioterapi” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës”**

**Pika të forta dhe afirmime:**

1. Programi dhe kurrikula mësimore e përshtatur me kurrikula europiane, e cila ndihmon në punësimin e këtyre profesionistëve brenda dhe jashtë vendit.
2. Përvoja disa vjeçare e Programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Fizioterapi” në UAMD (hapja për herë të parë në vitin akademik 2013-2014).
3. Kërkesat dhe nevojat e shoqërisë gjithmonë e në rritje për këtë program studimi, pasi vihet re se kuotat plotësohen që në raundin e parë.
4. Infrastruktura e mirë e ambienteve të mësimdhënies (vidioprojektor, tavolina, karrige, system ngrohje-ftohje), por edhe prania e një laboratorit fizioterapie, me aparaturo bashkëkohore, ofron kushte optimale për zhvillimin e praktikave laboratorike të programit të studimit Bachelor në Fizioterapi.
5. Sigurimi i cilësisë përmes njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, hartimit të politikave të vlerësimit, përgatitjen e instrumentave, mënaxhimit e procesit të vlerësimit, përgatitjen e raporteve, përfshirja e të gjithë aktorëve në këtë proces, etj.
6. Akreditimi institucional për një periudhë 4 vjeçare deri në vitin 2026.( në vitin 2016 procesit të Akreditimit Institucional dhe ka marrë Akreditim për 5 vite akademike, si dhe riakreditimit me Vendim Nr. 18 Datë 24.03.2022 dhe u riakreditua për 4 vite deri në datën 23.03.2026).

**Pika të dobëta:**

1. Numri i pakët i stafit akademik efektiv, për programin e studimit Bachelor në Fizioterapi (Standardi I.1, Kriteri 4)
2. Numri i pakët i stafit akademik efektiv me gradat dhe kualifikimet specifike për lëndët profesionale të programit të studimit Bachelor në Fizioterapi (Standardi I.1, Kriteri 4) (Standardi III.1, Kriteri 4) (Standardi IV.1, Kriteri 2)
3. Mungesa e linjave të transportit publik, që vështirëson frekuentimin cilësor nga ana e studentëve të programit të studimit Bachelor në Fizioterapi.
4. Mungesa e mobiliteteteve (ERASMUS) të studentëve të programit të studimit Bachelor në Fizioterapi
5. Mungesa e literaturës fizike për lëndët profesionale në bibliotekë për programin e studimit Bachelor në Fizioterapi (Standardi IV.3, Kriteri 4)



## **Rekomandime:**

### **GVJ sygjeron:**

1. Rekrutimin e stafit akademik efektiv për të rritur numrin e PAE, me grada dhe trajnime-kualifikime specifike për programin e studimit Bachelor në Fizioterapi
2. Rritja e numrit të literaturës fizike për lëndët profesionale në bibliotekë për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi”
3. Rishpërndarjen e ngarkesës mësimore për PAE sipas udhëzimit 29 të MAS, duke bërë të mundur rekrutimin e PAE me grada dhe trajnime specifike për programin e studimit Bachelor Fizioterapi.
4. Rritje e mundësisë për tu përfshirë në projekte ndërkombëtare, për shkëmbim eksperience dhe zhvillim kapacitetesh në kuadër të bashkëpunimit me institucionet partnere ndërkombëtare rekomandojme që përqindja e studentëve ose anëtarëve të stafit akademik pjesëmarrës në mobilitete të rritet.

### **Evaluation’s conclusions for the first cycle study program Bachelor in “Physiotherapy” provided by the University “Aleksandër Moisiu” Durrës**

#### **Strengths and Affirmations:**

1. The curriculum adapted according to the European curriculum, which helps in the employment of these professionals inside and outside the country.
2. Several years of experience of the first cycle of Bachelor studies in "Physiotherapy" at UAMD (opening for the first time in the academic year 2013-2014).
3. The demands and needs of the society are always growing for this study program, as it is noticed that the quotas are filled from the first round.
4. The good infrastructure of the teaching facilities (video projector, tables, chairs, heating-cooling system), but also the presence of a physiotherapy laboratory, with modern equipment, offers optimal conditions for the development of laboratory practices of the Bachelor in Physiotherapy study program.
5. Quality assurance through the Internal Quality Assurance unit, drafting of evaluation policies, preparation of instruments, management of the evaluation process, preparation of reports, involvement of all actors in this process, etc.
6. Institutional accreditation for a period of 4 years until 2026 (in 2016 the Institutional Accreditation process and received accreditation for 5 academic years, as well as reaccreditation with Decision No. 18 Date 24.03.2022 and was reaccredited for 4 years until 23.03. 2026).

#### **Weaknesses**

1. The small number of effective academic staff for the Bachelor of Physiotherapy study program (Standard I.1, Criterion 4).
2. The small number of effective academic staff with specific degrees and qualifications for the professional subjects of the Bachelor in Physiotherapy study program (Standard I.1, Criterion 4), (Standard III.1, Criterion 4), (Standard IV.1, Criterion 2 ).

3. The lack of public transport lines, which makes quality attendance difficult for the students of the Bachelor in Physiotherapy study program.
4. Lack of mobilities (ERASMUS) of students of the Bachelor in Physiotherapy study program.
5. Lack of physical literature for professional subjects in the library for the Bachelor of Physiotherapy study program (Standard IV.3, Criterion 4).

### **Recommendation**

1. Recruitment of effective academic staff to increase the number of PAE, with degrees and specific training-qualifications for the Bachelor of Physiotherapy study program
2. Increasing the number of physical literatures for professional subjects in the library for the Bachelor study program in "Physiotherapy"
3. The redistribution of the teaching load for PAE according to instruction 29 of the MAS, making possible the recruitment of PAE with specific degrees and training for the Bachelor of Physiotherapy study program.
4. Increasing the possibility to be involved in international projects, for exchange of experience and development of capacities within the framework of cooperation with international partner institutions, we recommend that the percentage of students or members of the academic staff participating in mobilities be increased.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

